

Analizë Vjetore 2020



AKPA

**AGJENCIA KOMBËTARE E
PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Analiza vjetore e Agjencisë Kombëtare të Punësimit
dhe Aftësive mbi ecurinë e aktiviteteve për vitin 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

FJALA HYRËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE	4
KAPITULLI I- KRIJIMI DHE MISIONI I AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE	7
A. KRIJIMI I AKPA-SË DHE BAZA LIGJORE	7
B. MISIONI DHE ORGANIZIMI I AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.....	8
KAPITULLI II- DINAMIKAT E TREGUT TË PUNËS PËR VITIN 2020.....	11
A. KONTEKSTI EKONOMIK DHE SOCIAL	11
B. POLITIKA E PUNËSIMIT NË SHIFRA DHE ZBATIMI I PATP-VE	12
1. <i>Shifrat e Papunësisë së regjistruar në Zyrat e Punësimit.....</i>	<i>12</i>
2. <i>Vendet e lira të punës të shpallura në Zyrat e Punës</i>	<i>14</i>
3. <i>Programet e Nxitjes së Punësimit.....</i>	<i>18</i>
4. <i>Programet e Formimit Profesional Publik.....</i>	<i>23</i>
5. <i>Pagesa e Papunësisë</i>	<i>24</i>
6. <i>Ofrimi i Shërbimeve Publike për shtetasit e huaj të punësuar në Republikën e Shqipërisë.....</i>	<i>25</i>
KAPITULLI III- NXITJA E MUNDËSIVE PËR PUNË TË DENJË NËPËRMJET POLITIKAVE AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS.....	27
A. RIORGANIZIMI FUNKSIONAL I ZYRAVE TË PUNËS SIPAS MODELIT KOMBËTAR TË SHËRBIMEVE	27
B. MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS DHE SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË NË AKPA.....	28
D. ZBATIMI I SISTEMIT TË MATJES SË PERFORMANCËS PËR OFRIMIN E PROGRAMEVE AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS	29
E. HARTIMI DHE DIVERSIFIKIMI PATP-VE NË BAZË TË NEVOJAVE TË GRUPEVE ME RREZIK TË LARTË PËR T’U BËRË TË PAPUNË AFATGJATË.....	30
F. PËRMIRËSIMI I PROCESIT TË PLANIFIKIMIT DHE ZBATIMIT TË PROGRAMEVE TË NXTIJES ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E EFICENCËS DHE IMPAKTIT TË TYRE	32
KAPITULLI IV- OFRIMI I ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL CILËSOR PËR TË RINJTË DHE TË RRRITURIT	34
A. OPTIMIZIMI I OFRUESVE TË AFP-SË.....	34
B. DIVERSIFIKIMI I OFERTËS NË FORMIM PROFESIONAL NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E TREGUT TË PUNËS	35
C. RISTRUKTURIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE PRANË DRFPP-VE.....	38
D. SISTEMI INFORMATIK PËR QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL DHE MENAXHIMI I TË DHËNAVE ADMINISTRATIVE/ STATISTIKAVE ZYRTARE TË AFP-SË	38
E. MONITORIMI, VLERËSIMI DHE LICENCIMI I OFRUESVE PRIVAT TË FORMIMIT PROFESIONAL	40
F. MONITORIMI I SUBJEKTEVE PRIVATE TË LIÇENCUARA PËR FORMIM PROFESIONAL	41
G. APLIKIMET ONLINE PËR REGJISTRIM NË KURSE FORMIMI PROFESIONAL NËPËRMJET PORTALIT E-ALBANIA.....	42

KAPITULLI V- PROMOVIMI I PËRFSHIRJES SOCIALE DHE I KOHEZIONIT TERRITORIAL43

- A. VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR SHËRBIME TË PUNËSIMIT DHE TË FORMIMIT NË ZONAT E PAMBULUARA ..43
- B. RITJIA E AKSESIT PËR SHËRBIME TË PUNËSIMIT DHE TË AFP-SË PËR GRUPET E VEÇANTA 44
- C. HARTIMI I SKEMËS RIINTEGRUESE NË TREGUN E PUNËS TË PËRFITUESVE TË SKEMËS SË NDIHMËS EKONOMIKE45

KAPITULLI VI- FUQIZIMI I QEVERISJES SË TREGUT TË PUNËS DHE I SISTEMIT TË KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE46

- A. KRIJIMI I AKPA SI INSTITUCION PËRGJEGJËS PËR ADMINISTRIMIN, MBIKËQYRJEN DHE ZBATIMIN E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT DHE MENAXHIMIT TË OFRUESVE PUBLIKE TË AFP -SË 46
- B. STAF I TRAJNUAR SIPAS FUNKSIONEVE DHE PËRGJEGJËSE TË AKPA SI DHE PËR APLIKIMIN DHE MENAXHIMIN E PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA PROGRAMET E BE-SË..... 47
- C. FORCIMI I SISTEMIT TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT TË POLITIKËBËRJES NË SEKTORIN E PUNËSIMIT DHE TË AFP-SË.....48
- D. FUQIZIMI I DIALOGUT SOCIAL PËR KONTRATAT KOLEKTIVE DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PUNËMARRËSVE48
- E. ZHVILLIMI DHE ZBATIMI I NJË SISTEMI KOMBËTAR TË INFORMACIONIT TË TREGUT TË PUNËS DHE AFP-SË 49

KAPITULLI VII- TRANSPARENCA, KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN.....50

- A. IMAZHI I RI INSTITUCIONAL50
- B. PUBLIKIMI I VENDEVE TË LIRA TË PUNËS (VLP).....50
- C. PROMOVIMI I RASTEVE TË SUKSESIT 50
- D. MENAXHIMI I KËRKESAVE TË SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË DOKUMENTACIONIT ME NËNSHKRIM ELEKTRONIK TË KËRKESAVE NGA TË TRETËT PËR AKPA51
- E. MENAXHIMI I SISTEMIT TË ANKESAVE NË AKPA.....52

KAPITULLI VIII- LIDHJET ME PROJEKTE, PROGRAME DHE PARTNERË STRATEGJIKË..... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**KAPITULLI IX- PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI BUXHETOR ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**

Fjala Hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive



Të nderuar Kolegë, bashkëpunëtorë dhe lexues!

Ju ftoj të njiheni me punën, sfidat dhe arritjet e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive gjatë vitit 2020. Situata e pandemisë solli vështirësi dhe sfida të reja në jetën dhe punën e secilit prej nesh. Por kjo situatë padyshim nxori në pah dhe frymën e bashkëpunimit dhe kujdesit tek të gjithë punonjësit tanë, të cilët me shumë përkushtim kanë kryer çdo detyrë për të përmbushur funksionin e tyre edhe pse në kushte të vështira.

Përpos sfidave të tjera, institucioni ynë Shërbimi Kombëtar i Punësimit u transformua në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) duke marrë mbi vete përgjegjësi dhe angazhime të reja, siç është administrimi i shkollave të arsimit profesional. Gjatë vitit 2020, u krye procesi i reformimit strukturor të institucionit në të gjitha nivelet, si në Drejtorinë e Përgjithshme, po ashtu në çdo Drejtori Rajonale, Zyrë Vendore dhe Drejtori të Formimit Profesional. Prosesi, në kushtet e situatës së jashtëzakonshme, nuk ishte i lehtë, por sot unë jam e lumtur që përmes implementimit të strukturës së re të AKPA, gjithsecili ka një pozicion pune me detyra qartësisht të përcaktuara, çka do të reflektohet tani e në vijim në përmirësimin e cilësisë e shërbimeve ndaj qytetarëve. Jam gjithashtu e lumtur, që brenda Drejtorisë Qëndrore të AKPA-s shumë prej punonjësve që kanë kontribuar prej vitesh në këtë institucion u motivuan duke u promovuar në strukturën e re të AKPA-s dhe ku padyshim do të kenë kontributin e tyre të shtuar për të bërë më të mirën për institucionin.

Një hap i rëndësishëm për institucionin është përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator sidomos në nivelet e shërbimeve të punësimit ku u punua për një përmirësim të ndjeshëm të metodologjive të ofrimit të shërbimeve. Së bashku me kolegët në AKPA përgjatë gjithë vitit janë hartuar:

- Udhëzuesi për ofrimin e shërbimeve të punësimit për punëkërkuarit dhe punëkërkuarit e papunë

- Udhëzuesi i Këshillimit drejt Punësimit
- Udhëzuesi për ofrimin e shërbimeve të punësimit për punëdhënësin
- Udhëzuesi mbi procedurat për pajisjen me librezën e vullnetarizmit
- Udhëzuesi për Orientimin në Karrierë dhe Formim Profesional
- Udhëzuesi për plotësimin e vendit të lirë të punës
- Udhëzuesi mbi planifikimin e proçeseve të punës
- Udhëzuesi i pagesës së papunësisë
- Udhëzuesi për marrëdhëniet e punës

Qëllimi i të gjithë udhëzuesve është rritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve ndaj punëkërkuësve dhe punëdhënësve, si dhe njehsimi e unifikimi i punës së të gjithë punonjësve në të gjithë nivelet e Agjencisë.

Një tjetër arritje që dua të ndaj me ju është puna e bërë për realizimin e Sistemit të Ri Informatik të Shërbimeve të Punësimit. Teknologjia sot është një mjet i domosdoshëm për të siguruar mbledhjen e shpejtë të informacionit, saktësinë e tij, përpunim të mirë dhe të shpejtë të të dhënave me qëllim që AKPA të sigurojë dhe informojë palët e interesuara mbi informacionin e tregut të punës në Shqipëri. Për zyrat e punësimit ky sistem do të jetë një mjet kryesor në punën e përditshme të specialistëve të shërbimeve të punësimit. Do të bëjë të mundur digjitalizimin e të dhënave për thujtë të gjitha shërbimet që ofrohen në zyrën e punës, mundësi shërbimesh më të mira për Bizneset etj. Tashmë të gjitha skedat qofshin këto të punëkërkuësve ashtu edhe ato të punëdhënësve do të jenë elektronike. Nëpërmjet integritimeve me sistemet e treta, do të bëhet i mundur saktësimi i të dhënave, shkurtimi i kohës së klientëve tanë për të marrë shërbimin duke përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin në punë të të gjitha burimeve njerëzore të AKPA.

Gjithashtu, është përmirësuar ndjeshëm dhe ka pasur një fokus të dedikuar për marrëdhëniet me publikun, duke filluar nga web faqja zyrtare akpa.gov.al, si dhe komunikimi, informimi, prezantimi i punës së bërë nga kjo agjenci në mediat sociale e më gjerë, gjithashtu dhe ngritja e sistemit të menaxhimit të ankesave në çdo Institucion varësie të AKPA si edhe në drejtorinë qendrore, kujdesi për kthimin e përgjigjes në kohë, analiza e çdo ankese, është një hap drejt përmirësimit të sistemit tonë të Përformancës.

Sa i përket fushës së Arsimit dhe Formimit Profesional, AKPA ka në strukturën e saj Qendrat e Formimit Profesional, të cilat këtë vit kanë bërë një punë shumë të mirë me rishikimin e të gjithë kurrikulavë të kurseve afatshkurtra në nivel qendror dhe atyre në Nivel Kombëtar në bashkëpunim të ngushtë me AKAFPK-në duke sjellë një ofertë mësimore të përmirësuar për çdo

sektor, ofertë të unifikuar për të gjithë sistemin, dhe të koordinuar sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Një risi ishte dhe implementimi i disa kurseve si Soft Skills dhe kurseve të digitalizimit të punëkërkesve duke qenë se 70% e klientelës së kursantëve vijnë nga Zyrat e Punës. Këto hapa drejt aftësisë të Punëkërkesve të Papunë drejt tregut të punës, janë hapa të vegjël por në rrugën e duhur drejt konsolidimit të Planeve Individuale të Punësimit. Çdo individ duhet të mbështetet për të arritur maksimumin e potencialeve të aftësive të tij për punë dhe jo vetëm. Bashkëpunimi midis Zyrave të Punës, Qendrave të Formimit Profesional, ndërtimi i protokolleve të punës së përbashkët, vendosja e targeteve të kombinuara do të mundësojë rezultate gjithmonë e më të mira të punësimit.

Sistemi IT i QFP-ve tashmë i cili ka përfunduar dhe është pilotuar në 3 QFP, gjatë vitit 2021 do të shtrihet në të gjithë QFP në Shqipëri duke mundësuar dhe lidhjen automatike me zyrat e punës dhe transferimin e informacionit të ndërsjelltë.

Një tjetër sfidë shumë e madhe përgjatë këtij Viti ishte procesi i Mësimdhënies Online. AKPA me ristrukturimin e saj mori nën menaxhimin dhe Shkollat e Arsimit të Mesëm Profesional. Ky vit ishte veçanërisht i veçantë për Shkollat e Arsimit Profesional si për shkak të këtyre ndryshimeve ashtu edhe përballjen me mbylljen fizike të tyre dhe kalimin në mësimdhënien online, ndërtimin e protokolleve të sigurisë në kushtet e reja etj. Do të thoja se jam e kënaqur që stafi i shkollave ka treguar profesionalizëm, përgjegjshmëri dhe aftësi shumë të mira për të menaxhuar situatën e mësimdhënies. Jam e bindur që për vitet që vijnë AKPA do të mbështesë dhe përmirësojë në bashkëpunim të ngushtë me shkollat, të gjithë proceset e punës dhe nevojat që kanë këto shkolla.

Rolet dhe funksionet e qarta, instrumentat e punës, sistemet e informacionit, ngritja e kapaciteteve të stafit, trajnimet dhe motivimi i stafit si dhe koordinimi i Institucioneve në varësi të Agjencisë janë dhe do të jenë në fokusin tonë, me synimin për të implementuar një model institucional evropian.

Të ndërgjegjshëm se mbetet akoma shumë për t'u realizuar në rrugën e gjatë të përmirësimit dhe vendosjes së një standardi më të lartë në ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional, Ju falenderoj të gjithëve për punën tuaj dhe në mënyrë të veçantë të gjithë projektet bashkëpunëtorë të AKPA-s pa të cilët nuk do të mund të kishim rezultate të tilla, si dhe angazhohemi me përkushtim çdo ditë për të përmbushur të gjithë objektivat dhe sfidat e ardhshme.

KAPITULLI I- KRIJIMI DHE MISIONI I AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

A. Krijimi i AKPA-së dhe baza ligjore

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) është një institucion publik, në varësi të ministrit përgjegjës për punësimin dhe zhvillimin e aftësive, e cila është krijuar dhe ushtron veprimtarinë administrative në bazë të Ligjit nr. 15/2019, “Për Nxitjen e Punësimit”, Ligjit Nr. 15/2017, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimit Nr. 554, datë 31.07.2019 “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”.

AKPA, më parë Shërbimi Kombëtar i Punësimit, u ngrit në bazë të VKM Nr. 42. datë 17.01.1998 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Këshillit Kombëtar të Punësimit”.

Objektivat e AKPA-së përcaktohen përmes dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, ku përkatësisht institucioni angazhohet në përmbushjen e 4 prioritetëve kryesore:

- A- Nxitja e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave aktive të tregut të punës;**
- B- Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit;**
- C- Promovimi i përfshirjes sociale dhe i kohezionit territorial;**
- D- Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemit të kualifikimeve profesionale.**

Në rrafshin institucional, AKPA ka këto përgjegjësi funksionale:

- Të garantojë nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për punësimin, vetëpunësimin dhe arsimin e formimin profesional, nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit;
- Të organizojë punën për administrimin dhe zbatimin e programeve aktive e pasive të tregut të punës;
- Të organizojë punën për administrimin e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional (AFP), sipas legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë;

- Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e drejtorive rajonale, të zyrave vendore dhe të ofruesve publikë të arsimit profesional;
- Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional, kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është institucion publik, i cili ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me:

- Ligjin Nr. 15/2019, "*Për nxitjen e punësimit*",
- Ligjin Nr.152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*"
- Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës*", i ndryshuar,
- VKM Nr. 554, datë 31.7.2019 "*Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive*";
- Urdhrin e Kryeministrit nr.172 datë 24.12.2019 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive*".

B. Misioni dhe organizimi i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Misioni:

Misioni i AKPA-së është të sigurojë përmbushjen e të drejtës së shtetasve shqiptarë, të huaj dhe pa shtetësi të huaj, që kanë përfituar statusin e refugjatit si dhe të azilkërkuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, për t'u trajtuar me shërbime dhe programe publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimeve profesionale, me qëllim gjetjen e një pune të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve.

Organizimi institucional:

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve të punësimit, të vetëpunësimit dhe të arsimit e formimit profesional, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për punësimin dhe zhvillimin e aftësive. AKPA shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet:

- në nivel qëndror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
- në nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale;
- në nivel vendor, nëpërmjet zyrave vendore.

Skema e Organizimit institucional:


- Drejtoria Qendrore
- 12 Drejtori Rajonale Punësimi
- 40 Zyra Vendore Punësimi
- 10 Drejtori Rajonale të Formimit Profesional Publik
- 34 Shkolla Profesionale

Buxheti total 2020:

1,699,000,000 ALL

Struktura dhe organigrama

Në zbatim të Vendimit Nr. 554, datë 31.07.2019 “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, struktura dhe organika e institucionit është sipas skemës së mëposhtme:



KAPITULLI II- DINAMIKAT E TREGUT TË PUNËS PËR VITIN 2020

A. Konteksti ekonomik dhe social


Punësimi dhe zhvillimi i aftësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës, vijoi të ishte një nga prioritetet e qeverisë edhe gjatë vitit 2020. Viti 2020 ka qenë një vit jonormal për shkak të pasojave të tërmetit të fundvitit 2019 dhe të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Në këtë kontekst për ekonominë shqiptare dhe për rrjedhojë dhe për punësimin, viti 2020 ka qenë një vit i vështirë dhe tepër sfidues. Gjithsesi AKPA si institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave të punësimin dhe aftësimin gjatë vitit 2020 është angazhuar maksimalisht për realizimin e objektivave të cilët kanë qenë dinamikë për shkak të situatës fluide. AKPA në nivel qendror, rajonal dhe vendor nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm me punëdhënësit dhe punëmarrësit ka ndihmuar në zbatimin sa më efikas të paketave të nxitjes së punësimin të ndërmarra në kuadër të situatës së shkaktuar nga Covid-19. Duhet theksuar se pavarësisht situatës jo të zakonit dhe kurbës së ç'rregullt që pësoi tregu i punës, në nivel vjetor realizimet e indikatorëve të pararendosur janë realizuar në një përqindje mjaft të kënaqshme. Mbyllja e plotë e aktivitetit social-ekonomik gjatë periudhës Mars-Maj u pasua me rritjen e papunësisë dhe rritjen e personave të regjistruar pranë zyrave të punës për përfitimin e pagesës së papunësisë, e cila për këtë periudhë kohore u dyfishua në vlerë. Gjithsesi në vijim situata u normalizua dhe tregu i punës iu rikthye normalitetit.

Sipas të dhënave të Anketës së Forcës së Punës¹ në 3 mujin e IV 2020 për popullsinë (15-64) vjeç:

- Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 68.7 %. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2019, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është ulur me 1 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm të vitit 2020 ky tregues ka pësuar një ulje prej 1.1 pikë përqindje.
- Shkalla e punësimin është 60.2%. Gjatë këtij tremujori, në terma vjetorë punësimi shfaq një tendencë rënie krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2019, prej 1.4 %. Në terma tremujorë, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2020, punësimi pësoi një rënie prej 1.1 pikë përqindje.

- Shkalla zyrtare e papunësisë është 11.8%. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2019, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0.6 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e tretë 2020, shkalla zyrtare e papunësisë pësoi një rritje prej 0.2 pikë përqindje.

Graf. 1 Ndryshimet në shkallën e punësimit sipas aktiviteteve ekonomike¹




B. Politika e punësimit në shifra dhe zbatimi i PATP-ve

Seksioni i mëposhtëm paraqet një analizë përshkruese të të dhënave statistikore që pasqyrojnë rezultatet kryesore të aktivitetit të Zyrave të Punës për periudhën Janar - Dhjetor 2020.


1. Shifrat e Papunësisë së regjistruar në Zyrat e Punësimit

Në muajin Dhjetor 2020 në ZP, figuronin të regjistruar 92,326 punëkërkues të papunë, 34.6% më shumë se numri i Pu.Pa., të regjistruar në Dhjetor 2019.

¹ Burimi INSTAT



Numri mesatar i pu.pa-ve të regjistruar në Zyrat e Punës gjatë 2020, ishte 82,921 individë. Vihet re se, një pjesë e konsiderueshme e regjistrimit të Pu.Pa-ve përbëhet nga persona të cilët përfshihen në një ose më shumë grupe të veçanta.



Duke e analizuar regjistrin e pu.pa-ve sipas moshës dhe arsimit, vihet re se rreth 49% e totalit të pu.pa-ve janë mbi 45 vjeç dhe 56% me arsim deri 9 vjeçar, çka e vështirëson integrimin e këtyre pu.pa-ve në tregun e punës. Kjo tendencë është me e theksuar në grupet e veçanta.

Punëkërkuessit e papunë të regjistruar sipas arsimit:

Totali	Më pak se fillor	Fillor	9 vjeçar	Mesme përgj.	mesme prof.	Universitare

82,921	2,805	3,241	40,374	22,568	7,235	6,698
--------	-------	-------	--------	--------	-------	-------

Punëkërkuësit e papunë të regjistruar sipas Grupmoshës:

Totali	15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50
82,921	2,660	7,708	8,193	7,626	7,850	8,528	9,472	30,883

Në dallim nga të gjithë kategoritë e tjera, kategoria romë/ egjiptianë karakterizohet nga një moshë relativisht e re dhe një mungesë të theksuar arsimimi. Këto karakteristika e rrisin vështirësinë e integritit të këtij grupi në tregun e punës, pasi përbën problem edhe për dërgimin e kësaj kategorie në kurse formimi profesional.

2. Vendet e lira të punës të shpallura në Zyrat e Punës


Për përcaktimin e treguesve të monitorueshëm për vitin 2020, AKPA mori në konsideratë situatën e jashtëzakonshme të krijuar nga pandemia e COVID-19, veçanërisht për treguesit të cilët lidheshin me regjistrimin e subjekteve të reja, shpalljen e VLP-ve dhe punësimin. Gjatë vitit 2020 u shpallën 25,141 vende të lira pune duke realizuar 106% të objektivit vjetor. Sipas aktiviteteve ekonomike numri më i lartë i vendeve të lira është marrë nga industria përpunuese (49%), informacioni dhe komunikacioni (12%), dhe ndërtimi (8%).

Aktivitete ekonomike	VLP të shpallura (%)
Industria Përpunuese (a+b+c+d)	49
Përpunimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe produkteve të duhanit	9
Përpunimi i tekstileve, konfeksionimi i veshjeve dhe prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	28
Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri, i letrës dhe produkteve prej letre, shtypshkrimet	6

Industri të tjera përpunuese	6
Informacioni dhe komunikacioni	5
Ndërtimi	8
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	12
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	6
Aktivitetet e tjera ekonomike	20


Sipas llojit të vendeve të lira të shpallura 76% prej tyre janë vende të reja pune. Në grafikun e mëposhtëm vihet re që në pjesën më të madhe të kategorive profesionale rreth 76% e vendeve të lira janë të reja të krijuara rishtazi. Në kategoritë profesionale ku kërkohen teknik dhe specialistë të mesëm, nëpunës, zejtarë dhe zanatçinj (32-35) % të vendeve të lira janë vende pune zëvendësime.

VENDET E LIRA SIPAS KATEGORIVE PROFESIONALE



Sipas kategorive profesionale numri më i lartë i vendeve të lira të shpallura është:

Kategoritë Profesionale	Nr. i VLP të shpallura
Zehtarët dhe Zanatçinjtë	40%
Profesionet elementare	20%
Nëpunës	6%
Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve	7%
Punonjës në industri	17%
Kategoritë e tjera profesionale	10%



Përputhja e Kërkesës me Ofertën së Pu.Pa., të regjistruar në ZP

Problematike mbetet përputhja e ofertës dhe kërkesës për punë e cila reflektohet në çdo kategori profesionale. Kërkesa për punë fokusohet më tepër në kategorinë e Zejtarëve dhe zanatçinjve me 40% të totalit të vendeve të lira të shpallura, ndërsa oferta përbën 16% të totalit të Pu.Pa-ve të regjistruar.

Edhe pse për këtë kategori kërkesa për punë është e konsiderueshme, Zyrat e Punësimit kanë mundur të plotësojnë vetëm 41% të VLP-ve të shpallura. Një pjesë e konsiderueshme e Pu.Pa-ve të regjistruar në këtë kategori nuk arrijnë të punësohen për shkak të moshës, arsimit dhe profesioneve specifike që ata kanë. Gjithashtu, prej totalit të Pu.Pa-ve të regjistruar në këtë kategori profesionale 49% e tyre janë afatgjatë dhe 30% trajtohen me Ndihmë ekonomike.

Kategoria e dytë me më shumë vende të lira janë profesionet elementare me 20% të Totalit të VLP-ve të shpallura, ndërsa oferta përbën 32% të totalit të PU.PA-ve të regjistruar. Punësimi i Pu.Pa-ve të kësaj kategorie paraqitet shumë i vështirë për shkak të numrit të ulët të VLP-ve, moshës së Pu.Pa-ve, arsimit dhe faktit se në këtë kategori ka një numër të lartë punëkërkuessish të papunë pa një profesion të mirëfilltë, çka mund të vlerësohen edhe si pa profesion.

Gjithashtu, Pu.Pa.-të, e përfshira në këtë kategori profesionale zënë një peshë të rëndësishme në kategoritë e vështira si 33% të afatgjatëve, 40% të ndihmës ekonomike, 42% të 'romëve dhe egjiptianëve' dhe 26% të aftësisë së kufizuar.

Punëkërkuessit e papunë të cilët janë pa profesion përbëjnë rreth 18% të regjistrit të punëkërkuessit. Sikurse tek profesionet elementare, përveç mungesës së vendeve të lira për punonjës të pakualifikuar, në këtë kategori 39% e Pu.Pa-ve trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 58% janë afatgjatë.

Punësimi

Pavarësisht vështirësive të tregut e punës të cilat u theksuan më tepër si pasojë e pandemisë, gjatë Janar- Dhjetor 2020 janë punësuar 23,118 punëkërkuess të papunë duke realizuar 139% të objektivit vjetor.

Krahasuar me planin vjetor të vitit 2020:

	Objektivi i vitit 2020	Realizimi viti 2020	% Realizim/ Objektiv
Ndërmjetësim	9,469	8,830	93%
Gjeti vetë punë	7,184	14,288	199%
Total punësimi	16,653	23,118	139%

Punësimi sipas kategorive të veçanta:

Kategoritë	Objektivi i vitit 2020	Realizimi viti 2020	% Realizim/ Objektiv
Pu.Pa, me aftësi të kufizuar	80	49	61%
Pu.Pa, Romë/ Egjiptianë	870	738	85%
Pu.Pa, të rinj (16-29 vjeç)	5829	8018	138%
Pu.Pa, nga NE	1263	1374	109%
Pu.Pa, nga pagesa e papunësisë	1,625	2728	168%

Për sa i përket punësimit të Pu.Pa-ve nga kategoritë e veçanta, objektivat për aftësinë e kufizuar dhe romë/ egjiptianët kanë hasur vështirësi në realizimin e plotë të treguesve të vendosur. Kjo erdhi si rezultat i situatës problematike si pasojë e pandemisë dhe karakteristikave specifike të këtyre grupeve të cilat e vështirësuan akoma më tepër punësimin e tyre.

3. Programet e Nxitjes së Punësimit

Për periudhën Janar- Dhjetor 2020 nga zbatimi i programeve të nxitjes për vitin 2020 kanë përfituar 751 subjekte dhe 4,146 individë, nga të cilët 171 subjekte dhe 1,319 individë janë aplikimet e vitit të kaluar.

Nëse do të shohim zbatimin e programeve për vitin 2020 kemi një paraqitje të realizimit të fondit të ndarë sipas VKM, si më poshtë:

VKM	Numri i projekteve	Numri i punëkërkesve të papunë	Fondi i konfirmuar për vitin buxhetor (në lekë)
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	162	341	510,363
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	90	273	2,221,986
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	85	491	1,279,678
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	3	30	606,265
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	125	1129	26,381,493
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	115	563	792,957
VKM 873	161	717	26,784,626
VKM 162	10	602	11,854,181
TOTALI	751	4146	70,431,549.00

Nga totali i pjesëmarrësve në PNP gjatë vitit 2020, rreth 67% e tyre ishin femra dhe 52% të rinj të moshës 16-26 vjeç.

	Programet e mbartura		Programet e reja		Total programe të zbatuara	
	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
Pjesëmarrës në PNP	1319	100%	2827	100%	4146	100%
<i>prej tyre</i>						
femra	856	65%	1922	68%	2778	67%
kryefamiljarë	81	6%	484	17%	565	14%
të rinjtë 16-29 vjec	1032	78%	1125	40%	2157	52%
nga pagesa e papunësisë	3	0%	313	11%	316	8%
nga ndihma ekonomike	39	3%	126	4%	165	4%

afatgjatë	142	11%	336	12%	478	12%
romë/ egjiptianë	27	2%	114	4%	141	3%
PAK	42	3%	25	1%	67	2%
Emigrantë të kthyer	5	0%	6	0%	11	0%

Programet e reja të Nxitjes së Punësimit

Për zbatimin e programeve të reja për vitin 2020, në raport edhe me miratimin e VKM-ve të reja, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive zhvilloi:

- një sërë trajnimesh për stafin lidhur me paketat e programeve të nxitjes së punësimit në çdo zyrë vendore punësimi
- fushatë sensibilizimi me të gjitha mjetet e informimit, fletëpalosje, prezantime të programeve me bizneset, publikime në faqen zyrtare të AKPA-s dhe në të gjitha Zyrat e Punësimit dhe takime online me bizneset dhe punëkërkuessit e papunë.

Në fund të muajit Gusht 2020, nisën procedurat për zbatimin e VKM-ve të reja të nxitjes së punësimit.

Gjatë vitit 2020, në programet e reja të PNP u përfshinë 580 subjekte dhe 2,827 punëkërkuess të papunë. Rreth 58 % e subjekteve u përfshinë në programet e VKM-së Nr. 17, ndërsa 61% e punëkërkuessve të papunë përfitues morën pjesë në programet e VKM-së, Nr. 608.

	Nr. Projektsh	Nr. Pjesëmarrësish
V.K.M 17 (Programi 1 Punesimi)	162	341
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nepermjet punes)	90	273
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punes)	85	491
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	3	30
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	126	1,129
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	114	563

Total	580	2,827
--------------	------------	--------------

Rreth 68% e numrit të pjesëmarrësve paraqiten në rajonet Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier dhe Gjirokastër.

Rajonet	Nr Pjesëmarrësish	%
Berat	134	5%
Dibër	75	3%
Durrës	395	14%
Elbasan	192	7%
Fier	285	10%
Gjirokastër	263	9%
Korçë	167	6%
Kukës	101	4%
Lezhë	129	5%
Shkodër	351	12%
Tiranë	627	22%
Vlorë	108	4%
Total	2827	100%

Numri më i lartë i punësimeve nëpërmjet VKM-së Nr. 17 (punësimi dhe formimi nëpërmjet punës), ishte në Industrinë Përpunuese, Akomodimin dhe shërbimin ushqimor, Ndërtim dhe Tregti. Praktikant Profesionalë u zhvilluan më së shumti në subjekte të cilat kanë si aktivitet ekonomik Shërbimet administrative dhe mbështetëse, administrimin publik dhe mbrojtjen, Arsimin, Shëndetësinë dhe Aktivitetet e mbrojtjes sociale.

Numri më i lartë i pjesëmarrësve të punësuar me programet e VKM-së Nr. 608 paraqitet në Industrinë Përpunuese, Akomodimin dhe shërbimin ushqimor, Ndërtim dhe Tregti.

	Industria Përpunuese	Akomodimi dhe shërbimi	Ndërtimi	Tregtia me shumicë dhe me	Transporti dhe magazinimi	Shërbime administrative dhe	Administrimi publik dhe	Arsimi	Shëndetësia dhe aktivitete të punës	Te tjera
V.K.M 17 (Programi 1 Punesimi)	35%	9%	8%	20%	1%	5%	2%	5%	1%	15%
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nepermjet punes)	62%	12%	7%	6%	0%	1%	0%	0%	0%	10%
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punes)	1%	0%	0%	0%	4%	24%	29%	10%	21%	10%
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	69%	10%	3%	3%	3%	1%	0%	3%	0%	7%
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	46%	10%	15%	9%	3%	1%	0%	2%	0%	14%
Total	48%	8%	6%	6%	3%	5%	5%	4%	4%	11%

Rreth 61% e pjesëmarrësve në programet e reja paraqiten në VKM-në Nr. 608, dhe 39% e pjesëmarrësve në VKM-në Nr. 17. Kategoritë si femrat, kryefamiljarët, pagesa e papunësisë, dhe romë/ egjiptianët kanë përfituar më tepër nga programet e VKM-së Nr. 608. Punëkërkuarit e papunë nga ndihma ekonomike, afatgjatët dhe aftësia e kufizuar kanë përfituar më tepër nga programet e VKM-së Nr. 17.

Në treguesit e monitorueshëm për vitin 2020 AKPA vendosi si objektiv për Programet e Nxitjes së Punësimit pjesëmarrjen në programet e reja të 5,000 punëkërkuarve të papunë, objektiv i cili arriti të realizohej në masën 56%. Ndikim të madh në mosrealizimin e treguesve pati situata e pandemisë.

Duke patur parasysh situatën e krijuar nga pandemia, AKPA dhe Zyrat e Punësimit kanë hasur vështirësi të shumta në implementimin dhe zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit si:

- Kriteret e vendosura fillimisht në VKM 17 dhe VKM 608 si përjashtimi i personave fizik

- Kushti i vendosur ndaj subjekteve te cilat nuk duhet kenë larguar punëtorë gjatë 4 muajve të fundit.
- Punëkërkuessi i papunë të jetë i regjistruar si pu.pa minimalisht prej 3 muajsh në zyrën e punësimit
- Studentët e diplomuar në vitin 2020 nuk mund të përfitonin nga programi i praktikave profesionale pasi duhet të ishin të regjistruar 3 muaj në Zyrën e punësimit.
- Numri i kufizuar i pu.pa-ve pjesëmarrës në VKM Nr.17 deri 20% të punonjësve në subjekte po jo më shumë se 21 pu.pa në të tre programet e kësaj VKM-je.
- Në sistemin e DPT shumë subjekte private dhe publike rezultojnë me detyrime, ndërsa subjektet pretendonin se i kishin shlyer këto detyrime
- Staf i zyrave në përgjithësi është i reduktuar për arsye të rasteve me Covid-19
- Problematika që vijnë nga tërheqja e subjekteve për arsye të tjera si ndërprerje kontratash, mbyllje për shkak Covid-19, mbyllje nga institucionet e ndryshme shtetërore për arsye detyrimesh apo rreziku, etj.

4. Programet e Formimit Profesional Publik

Në periudhën Janar- Dhjetor 2020 kanë ndjekur kurset e formimit profesional 4,421 punëkërkuessi të papunë (prej tyre 4,386 ne QFP-të publike) ose rreth 5% të totalit të punëkërkuessve të papunë të regjistruar në Zyrat e Punës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i pjesëmarrësve në kurse formimi rezultojnë të jetë vetëm 50% e realizimit të vitit 2019.

Si pasojë e pandemisë, gjatë periudhës Mars – Maj 2020 QFP-të publike e ndalën aktivitetin e tyre duke e rinisur në muajin Qershor. Pas përfundimit të kurseve të nisura në tremujorin e parë 2020, në Shtator u hapën kurset e reja të formimit profesional duke ulur numrin e kursantëve në klasa në kuadër të masave të marra për parandalimin e përhapjes së COVID- 19.

Emërtimi i Q.F.P-se	Totali i të regjistruarve në kurse	Prej tyre		Totali i të certifikuarve	Prej tyre	
		Femra	Punëkërkuessi të papunë		Femra	Punëkërkuessi të papunë
Qfp Nr.1	1195	539	453	549	267	199

Qfp Nr.4	1305	554	670	688	296	319
Qfp Durrës	935	376	633	494	180	296
Qfp Fier	706	193	487	266	87	172
Qfp Vlorë	821	350	447	436	193	224
Qfp Gjirokastrë	475	158	305	197	69	114
Qfp Elbasan	1154	441	694	539	202	221
Qfp Korçë	450	149	342	137	54	99
Qfp Shkodër	184	90	153	55	20	38
Qendra Lëvizëse	202	179	202	64	53	64
TOTAL 1 Kurset e reja 2020	7427	3029	4386	3425	1421	1746
TOTAL 2 Kurset e reja+ të mbartura	11759	4664	6951	7205	2894	3953

Prej totalit të 11,759 kursantëve të cilët kanë ndjekur kurset e formimit profesional gjatë vitit 2020 (të reja dhe të mbartura), rreth 61% prej tyre janë çertifikuar.

Për sa i përket pjesëmarrjes së grupeve të veçanta, treguesit e formimit në Kartën e Performancës 2020 janë tejkaluar përveç treguesit të kategorisë romë/ egjiptianë.

Formim profesional	Objektivi 2020	Realizimi 2020	% Realizim/ Objektiv
Pu.Pa pjesëmarrës në formim	3,518	4386	125%
Rom/ Egjiptianë	153	128	84%
PAK	27	56	207%
Ndihmë ekonomike	126	170	135%

5. Pagesa e Papunësisë

Si pasojë krizës së shkaktuar nga pandemia, gjatë 3 mujorit të dytë të vitit 2020, Zyrat e Punës u përballën me një numër të lartë aplikimesh për përfitimin e pagesës së papunësisë.

Edhe pse numri i aplikimeve për punëkërkuetit për përfitimet e papunësisë gjatë periudhës Prill-Qershor 2020 ishte i konsiderueshëm, disa nga punëkërkuetit ishin përfitues të njëjës prej tre paketave të ofruara nga qeveria. Zyrat e Punësimi gjatë kësaj periudhe verifikuan listat e DPT-së për përfituesit e këtyre paketave. Nëse vërtetohej që këta punëkërkuetit përfitonin një nga paketat, procedura për marrjen e përfitimeve të papunësisë pezullohej. Nga Korriku i vitit 2020, Zyrat e Punësimi verifikuan të gjitha aplikimet, nga të cilat rezultoi se një pjesë e aplikantëve ishin të punësuar. Për punëkërkuetit që rezultonin ende të papunë, procedurat për marrjen e përfitimeve të papunësisë vazhduan.

Tabela në vijim paraqet numrin e pu.pa-ve përfitues të pagesës së papunësisë gjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020.

	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Përfituesit e pagesës së papunësisë	2,981	4,088	3,748	3,133	5,802	6,399	6,701	6,387	5,945	5,820

Gjatë periudhës Mars- Qershor 2020, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 161, datë 21.03.2018 “Për pagesën të ardhurës nga papunësia” dhe VKM-së Nr. 254, datë 27.03.2020, rezultuan përfitues të pagesës së papunësisë 5,972 individë, prej tyre:

- numri i përfituesve të shumës 26,000 lek/ muaj ishte 2,866 pu.pa, prej tyre 1,294 femra
- numri i përfituesve të shumës 13,000 lek/ muaj ishte 3,106 pu.pa, prej tyre 1,884 femra

6. Ofrimi i Shërbimeve Publike për shtetasit e huaj të punësuar në Republikën e Shqipërisë

Gjatë vitit 2020, janë pajisur me leje dhe vërtetime pune 3,341 shtetas të huaj ose 12% më pak se viti 2019.

- I. **Vërtetime Deklarimi për Punësim**- janë pajisur 1,247 shtetas të huaj ose 22% më pak se viti 2019, prej tyre:
 - 29% janë dhënë në Ndërtim, 10% në Tregti me shumicë dhe pakicë, dhe 9% në Transport dhe magazinim, si dhe 8% në Arsim
 - 25% janë shtetas italian, 9% kosovarë, 5% anglezë dhe 6% amerikanë.

II. **Leje pune-** janë pajisur 2,094 shtetas të huaj ose 5% më pak se viti 2019, prej tyre:

- 24% janë dhënë në Ndërtim, 11% në Bujqësi, 8% Industrinë Përpunuese, dhe 8% në Tregti me shumicë dhe pakicë
- 32% janë shtetas turq, 4% kinezë, 13% egjiptianë dhe 5% filipinezë.

KAPITULLI III- NXITJA E MUNDËSIVE PËR PUNË TË DENJË NËPËRMJET POLITIKAVE AKTIVE TË TREGUTTË PUNËS

A. Riorganizimi funksional i zyrave të punës sipas modelit kombëtar të shërbimeve

Një ndër proceset më të rëndësishëm dhe sfidues për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive gjatë vitit 2020 ka qenë procesi i ristrukturimit në nivel qendror dhe rajonal. Me hyrjen në fuqi të ndryshimit të Urdhërit të Kryeministrit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka mbyllur procedurat e ristrukturimit të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (përfshirë Zyrat Vendore të Punës). Synimet kryesore të këtij ristrukturimi lidhen me ndarjen e roleve dhe përgjegjësive, profilizimin e qartë të punonjësve, optimizimin e punës dhe ofrimin e një shërbimi adekuat për punëdhënësit dhe punëmarrësit. 40 zyra punësimi janë riorganizuar dhe operojnë me modelin e ri të shërbimeve të punësimit. Proces i ristrukturimit u bazua mbi parimin e unifikimit dhe standardizimit të roleve dhe modelit të ofrimit të shërbimeve. Ky proces u shoqërua me përcaktimin e qartë të profilit profesional/akademik që duhet të ketë secili pozicion pune. Po ashtu paralelisht u përgatit dhe manuali i proceseve të punës për secilin pozicion. Proces i ristrukturimit ka vijuar paralelisht me përgatitjen e manualit të shërbimeve të punësimit dhe me sistemin e ri informatik, në formë të tillë që rritja e nivelit të shërbimeve të trajtohet në të gjitha dimensionet. Manuali i ri shërbimeve është konceptuar si një përmbledhje e të gjithë udhëzuesve të shërbimeve të punësimit (10 udhëzues). Udhëzuesit që përbëjnë manualin e ri të shërbimeve që kanë si qëllim orientimin e punonjësve dhe që përshkruajnë të gjitha proceset e punës, janë si më poshtë: Udhëzuesi për ofrimin e shërbimeve të punësimit për punëkërkuesit dhe punëkërkuesit e papunë, Udhëzuesi i Këshillimit drejt Punësimit, Udhëzuesi për ofrimin e shërbimeve të punësimit për punëdhënësin, Udhëzuesi mbi procedurat për pajisjen me librezën e vullnetarizmit, Udhëzuesi për Orientimin në Karrierë dhe Formim Profesional, Udhëzuesi për plotësimin e vëndit të lirë të punës, Udhëzuesi mbi planifikimin e proceseve të punës, Udhëzuesi për marrëdhëniet e punës, Udhëzuesi i pagesës së papunësisë, Udhëzuesi i lejeve të punës. Staf i zyrave të punës është trajnuar për implementimin e PIP. Gjatë 6 mujorit të parë parashikohet të

realizohet pajisja me PIP e të gjithë punëkërkesve në databazë. Gjatë vitit 2020 janë kryer trajnime online si dhe fizikisht për secilën zyrë dhe rajon. Për sa i përket trajnimeve mbi manualin e ri të shërbimeve kanë përfunduar trajnimet për 5 udhëzuesit e parë dhe parashikohet të përfundojnë trajnimet edhe për udhëzuesit e tjerë brenda 6 muajve të parë të vitit 2021. Përmes IPA II do të krijohet databaza me trajnimet e kryera për çdo punonjës/specialist dhe do të zhvillohen trajnime në kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit. Manuali i ri shërbimeve më datë 31.12.2020 është prezantuar për konsultim në Këshillin Konsultativ të Punësimit në formë të tillë që përfaqësuesit kryesor të punëdhësve dhe punëmarrësve të jenë të informuar mbi zhvillimet që synojnë përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve. Ndërkohë që gjatë vitit 2021 parashikohet të realizohet dhe vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga zyrat e punësimit.

B. Modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë në AKPA

Nga 40 zyra punësimi gjithsej, gjatë vitit 2020, 36 rezultojnë të rikonstruara dhe për vitin 2021 është parashikuar edhe rikonstruktimi i 4 zyrave të mbetura. Zyrat e Punës në vazhdimësi nëpërmjet bashkëpunimeve me partnerët janë mbështetur me pajisje mbështetëse si printera, bazë materiale etj. Gjatë këtij viti në Zyrat e Punës janë shpërndarë: 42 printera multifunksionale, 76 dollapë pune (49 dollap për dokumenta dy kanatësh dhe 27 dollap metalik me kanata rrëshqitese), 81 tavolina të llojeve të ndryshme, 179 karrike (58 rrotulluese dhe 121 të thjeshta), 51 etazher (rafte) për zyrë etj.

Gjatë vitit 2021 në kuadër të përmirësimeve të standardit të ofrimit të shërbimeve është parashikuar të bëhet një vlerësim i gjithë gjëndjes infrastrukturore të zyrave të punësimit. Pas një vlerësimi në nivel kombëtar dhe krijimit të një databaze të përditësuar të gjëndjes infrastrukturore do të planifikohet një plan konkret ndërhyrje. Paraprakisht mendohet se do të jetë i nevojshëm përmirësimi i bazës kompjuterike të zyrave pasi me vënien në funksion të plotë të sistemit të ri ku të gjitha shërbimet do të ofrohen brenda një sistemi të unifikuar, sistemi kompjuterik do të duhet t'i përgjigjet në mënyrë adekuate standardeve të sistemit. Është kërkuar asistencë e IPA për vlerësimin e gjëndjes aktuale dhe ndërtimin e databazës si dhe parashikohet ndihmesa e tyre për pjesën e brandimit të të gjithë drejtorive rajonale dhe zyrave të punësimit me logot e reja të AKPA.

Sistemi i ri informatik pritet të jetë plotësisht funksional brenda 6 mujorit të parë të vitit 2021. Për shkak të kompleksitetit, nevojës për kolaudimin e të gjithë parametrave sipas kërkesave/standardeve të kontratës si dhe për vetë sfidën e kalimit live dhe transferimit të të dhënave është parashikuar që implementimi i sistemit të ri të bëhet gradualisht dhe me module. Janë kolauduar modulet e punëdhënësit, punëmarrësit, VLP dhe ndërmjetësimit automatik. Në 3 mujorin e fundit të vitit 2020 u njohën dhe trajnuan për sistemin perfaqësues nga të gjitha drejtoritë/zyrat. Gjithashtu në vijim të trajnimeve fizike janë kryer dhe trajnime online me punonjësit që do të punojnë me sistemin. Ndërkohë që edhe në muajt e parë të vitit 2021 në kontekstin e përgatitjeve finale për vënien në funksion të sistemit janë parashikuar trajnime fizike për çdo zyrë punësimi.

Në lidhje me Website, aktualisht me ngritjen e AKPA-së është strukturuar dhe Website i ri i këtij institucioni i cili përmban informacion të përditësuar. Gjatë vitit 2021 ky website do të pasurohet dhe me statistikat e publikueshme të cilat do ta kthejnë AKPA-në jo vetëm institucion që siguron të dhëna për palë të tjera por në institucion gjenerues të dhënash.

D. Zbatimi i sistemit të matjes së performancës për ofrimin e programeve aktive të tregut të punës

AKPA nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Performancës gjatë vitit 2020 ka përmirësuar sistemin e planifikimit vjetor të punës, detyrave dhe objektivave nëpërmjet implementimit të programit Smartsheet. Për çdo drejtori janë parashikuar detyrat specifike, afatet, personat përgjegjës dhe indikatorët. Ndërkohë që për drejtoritë rajonale dhe zyrat e punësimit është hartuar matrica e proceseve të punës e cila në mënyrë të detajuar parashikon proceset e punës dhe afatet kohore për çdo procedurë të punës dhe për çdo funksion pune. Ky dokument i hartuar ka shërbyer dhe për hartimin e Udhëzuesit mbi planifikimin e proceseve të punës. Planifikimi është një nga funksionet bazë të menaxhimit dhe monitorimit të performancës për institucionin, i cili përfshin hartimin e një apo më shumë planeve për të arritur optimizmin e balancave të nevojave apo kërkesave me burimet e mundshme të disponueshme. Element shumë i rëndësishëm është manuali i proceseve të punës, i cili ka për qëllim të përcaktojë në detaje rolin, detyrat, si dhe afatet e realizimit të tyre brenda njësisë publike. Përgjegjësia e detyrave, veprimtaria, kontrolli dhe sistemi raportues janë të përcaktuara qartë në këtë manual. Manuali është i bazuar në hartën e proceseve të punës dhe në procedurat administrative të miratuara sipas legjislacionit në fuqi që rregullon

veprimtarinë e Drejtorive Rajonale të Punësimit, si dhe akteve të brendshme rregullatore. Gjithashtu, ai përshkruan të gjitha proceset e punës në njësi duke lejuar identifikimin e dobësive, si mungesën e ndarjes së detyrave apo mungesën e zëvendësuesve të personave përgjegjës. Kjo përjasje ndihmon që njësi publike të jetë e sigurt se nuk ka asnjë aktivitet pa person përgjegjës dhe që të gjithë anëtarët e stafit kanë përgjegjësitë përkatëse me qëllim që të garantohet përmbushja e funksioneve dhe objektivave strategjik të njësisë publike. Manuali i proceseve të punës është parashikuar të inkorporohet dhe në sistemin e ri informatik dhe nëpërmjet tij do të ndërtohen dhe një pjesë e Raporteve Menaxheriale (Statistikore). Sistemi nëpërmjet modulit të raporteve statistikore do të ofrojë një hapësirë të posaçme për gjenerimin e raporteve statistikore të ndryshme. Këto raporte do të shërbejnë për monitorimin e treguesve të monitorueshëm si dhe trendeve të punësimit. Do të realizohen raportet e performancës në zbatim të objektivave në nivel zyre dhe specialisti si dhe monitorimi në kohë reale nëpërmjet trendeve dhe targete-ve, krahasim të performancës së drejtorive me njëra tjetrën (paraqitje tabelare dhe grafike). Megjithëse sistemi i ri parashikohet ta zhvillojë matjen e performancës në një tjetër nivel, edhe aktualisht burimet njerezore të AKPA dhe drejtoritë e përmbajtjes gjatë vitit 2020 kanë vlerësuar me tregues performance secilën njësi duke iu referuar Treguesve të Monitorueshëm dhe Kartës së Performancës. Për sa i përket trajnimit të sftateve, janë kryer trajnime të vazhdueshme mbi të gjitha proceset/zhvillimet që janë realizuar apo janë në proces. Gjithashtu trajnimet dhe identifikimi i nevojave janë parashikuar të realizohen nga IPA në kuadër të mbështetjes për forcimin e kapaciteteve. Në diskutimet e kryera me ekspertët e IPA është specifikuar kërkesa për identifikimin e nevojave, për kryerjen e trajnimeve të identifikuara nga AKPA në kontekstin e rregullores dhe udhëzuesve të rinj dhe për krijimin e databazës së trajnimeve.

E. Hartimi dhe diversifikimi PATP-ve në bazë të nevojave të grupeve me rrezik të lartë për t'u bërë të papunë afatgjatë.

Në zbatim të Programit të Qeverisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për mbështetjen e punëkërkesve të papunë me programet aktive të Nxitjes së Punësimit, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi vuri në zbatim paketën ligjore sipas VKM-ve të miratuara si më poshtë:

- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.17, datë 15.01.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale” i ndryshuar,
- Vendimit Nr. 348, datë 29.4.2020 “ Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet Vetëpunësimit”,
- Vendimit Nr. 535, datë 8.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet”,
- Vendimit Nr. 608, datë 29.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19” i ndryshuar.
- Programet e nxitjes së punësimit përfshirë dhe VKM-në Nr. 608, datë 29.07.2020, janë konceptuar në formë të tillë që përvec ndihmës që mund të kenë bizneset në situatën e vështirë të pandemisë, të adresojnë dhe nevojat e kategorive të disavantazuara të punëkërkesve të papunë.

AKPA njoftoi zyrtarisht për nisjen e procedurave të zbatimit të programeve dhe fillimin e aplikimeve në Buletinin e njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.59, date 24.08.2020. Gjatë vitit 2020 u vunë në zbatim programet sipas VKM-së Nr.17, VKM-së Nr.608. Në fund të vitit 2020 pas hartimit dhe miratimit filloi të pilotohet VKM-ja Nr.348 për Vetëpunësimin, në katër rajone: Tiranë, Shkodër, Kukës dhe Dibër. Në zbatim edhe te Vendimit Nr. 1 të Këshillit Konsultativ të Punësimit, AKPA në zbatimin e programeve të reja synoi përfshirjen e sa më shume punëkërkesve të papunë, nëpërmjet aplikimit edhe te gërshtimit të përfitimit nga disa programe njëherazi.

Në vijim të miratimit të programeve të reja 329 punonjës të zyrës dhe stafit drejtues u trajnuan për këto programet.

Për sa i përket politikave aktive të tregut të punës, programet e reja të nxitjes së punësimit janë zhvilluar mbi qasjen e përmirësimit të nevojave të gjeneruara në bazë të analizave. Përmirësimi i VKM-ve është realizuar dhe në planin afatshkurtër nëpërmjet ndryshimeve në VKM, duke adresuar problematika të hasura gjatë implementimit. Përmirësimi i aspektit analitik pritet të ndihmohet nga avantazhet e moduleve menaxheriale/statistikore që do të japë sistemi i ri.

F. Përmirësimi i procesit të planifikimit dhe zbatimit të programeve të nxitjes me qëllim përmirësimin e efencës dhe impaktit të tyre.

- Planifikimi

Gjatë vitit 2020 nëpërmjet udhëzimit Nr. 25, datë 16.06.2020 është përgatitur metodologjia për shpërndarjen e fondeve të programeve të nxitjes së punësimit. Nëpërmjet metodologjisë janë përcaktuar kriteret (nr. Punëdhënësve të regjistruar, nr. Punekerkuesve të Papunë të regjistruar, treguesit e monitorueshëm për çdo rajon dhe zyrë) mbi të cilat do të realizohet shpërndarja e fondeve. Realizimet e indikatorëve dhe fondi i shpenzuar monitorohen në mënyrë të vazhdueshme, ku në bazë të realizimeve kryhen ndryshime dhe rishpërndarje të indikatorëve dhe fondeve. Rezulton se ka patur njëshpërndarje mjaft pozitive të fondeve për sa i përket aspektit gjinor pasi në fund të vitit 2020, nga numri total i përfituesve prej 4146 individësh, 2776 janë femra ose 67 % e totalit. Përgjatë vitit 2020 çdo rajon/zyrë ka implementuar programe nxitjeje sipas shpërndarjes së mëposhtme:

Rajonet	BERAT	DIBER	DURRES	ELBASAN	FIER	GJIROKAST	PR	KORCE	KUKES	LEZHE	SHKODER	TIRANE	VLORE	GJITHSEJ
Te reja	134	75	395	192	285	263	167	101	129	351	627	108	2827	
Te mbartura	53	92	81	6	223	98	179	32	126	201	136	92	1319	
Totali	187	167	476	198	508	361	346	133	255	552	763	200	4146	

- Zbatimi i PAPT-ve

Spektori përkatës në AKPA-n qendore është ngritur dhe monitoron punën e zyrave për këtë aspekt. Spektori përveç mbledhjes së informacionit të përditshëm, ka hartuar edhe relacione periodike lidhur me rezultatet dhe problematikën. Bazuar në këtë monitorim të procesit të nxitjes, në fund të vitit 2020 u hartuan dhe propozime për ndryshime e përshtatje në VKM-të e nxitjes

- Monitorimi

Gjatë vitit 2020 fokusi ka qenë në përgatitjen e progameve të reja si dhe në impelmentimin me sa më sukses të PATP-ve në kushtet e vështira të pandemisë. Strukturat përkatëse në AKPA kanë monitoruar në vazhdimësi ecurinë dhe përmbushjen e indikatorëve duke kryer dhe analizën e realizimeve vjetore. Gjatë vitit 2021 do t'i kushtohet një vemëndje e shtuar procesit të monitorimit duke ndërthurur monitorimin në terren me monitorimin e treguesve të monitorueshëm.

KAPITULLI IV- OFRIMI I ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL CILËSOR PËR TË RINJTË DHE TË RRITURIT

A. Optimizimi i Ofruesve të AFP-së

Një nga prioritetet më të rëndësishme të vitit 2020 në fushën e AFP-se ka qenë riorganizimi i ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional. Qëllimi i procesit është Optimizimi i Ofruesve të AFP-së në nivel individual dhe rrjeti për të siguruar një ofertë më cilësore dhe të larmishme, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Në vijim të zbatimit të masave të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022 (Prioriteti Strategjik B, nënobjektivi “riorganizimi i rrjetit të ofruesve të AFP-së bazuar në nevojat për të përshtatur ofertën me kërkesat e tregut të punës”) është realizuar procesi i analizës dhe përgatitjes së propozimeve për optimizimin e ofertës së arsimit dhe formimit profesional, i cili synon hartimin e një dokumenti i cili do të seshi do të orientohet oferta e ofruesve të AFP-së në vijimësi. Organizimi i ofruesve, parashikohet të rishikohet jo vetëm në optikën se çfarë ofruesish operojnë aktualisht, por dhe të kombinimit që do të kemi të qendrave shumë- funksionale, shkollave dhe qendrave të formimit profesional.

Procesi i optimizimit gjatë vitit 2020, është shtrirë sipas disa fazave. Në fillim të muajit shkurt 2020, u organizua një takim tematik “punësimi dhe aftësitë” me përfaqësues nga të tri institucionet kryesore dhe përfaqësues të projekteve për zhvillim, të cilët janë angazhuar në vazhdimësi në reformën e AFP-së e posaçërisht në ri-organizimin e ofruesve të AFP-së, si: GIZ, UNDP, SDC, Bashkëpunimi Italian për Zhvillim, etj. Gjatë këtij takimi u prezantuan metodologjitë dhe rekomandimet kryesore të studimeve dhe analizave të viteteve 2014, 2015, 2017 dhe 2019.

Gjatë periudhës mars – qershor 2020, në këtë kuadër u përcaktua metodologjia e procesit dhe katër kriteret kryesore, mbi bazën e të cilave është zhvilluar analiza për optimizimin:

1. Konteksti social- ekonomik
2. Punësimi sipas sektorëve/ profesioneve
3. Performanca e AFP-së në vite

4. Mbulimi gjeografik nga ofruesit e AFP-së

Për sa më lart, me qëllim realizimin e një analize më të saktë, u morën në shqyrtim 4 rajone gjeografike dhe statistikore (veri, juglindje, jugperëndim, qendror). Për secilin rajon dhe qarqet brenda rajonit u zhvillua analiza e situatës social-ekonomike dhe e tregut të punës, ndërkohë që analiza e ofruesve u bazua në një rivlerësim të eficiencës dhe efektivitetit të tyre bazuar në 10 kriteret e aplikuara edhe në studimin bazë të kryer nga GIZ dhe Fondacioni Evropian i Trajnimit (ETF) në vitin 2014. Rivlerësimi i ofruesve u realizua bazuar në të gjithë informacionin e vënë në dispozicion nga studimet dhe analizat e mëparshme, të dhënat administrative të MFE-së, si dhe studimi më i fundit për nevojat për investime në AFP, i realizuar gjatë vitit 2019 nga Banka Gjermane për Rindërtim (Kfw).

Në mbështetje të këtij procesi, AKPA ka realizuar vizita monitoruese në të gjithë ofruesit publikë të AFP-së gjatë muajit korrik 2020, raporti i të cilave përbën një dokument bazë për diskutimet dhe vendimarrjet mbi të ardhmen e këtij procesi. Pas përfundimit të analizës në periudhën qershor – gusht 2020, AKPA, në bazë të propozimeve paraprake u dakortësua propozimi final për optimizimin, i cili u prezantua pranë Ministrisë së linjës. Në këtë kuadër, AKPA ka hartuar planin për zbatimin e procesit të optimizimit, për zbatimin e të cilit është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës. Agjencia, për vitin e ardhshëm, parashikon rishikimin dhe hartimin e bazës ligjore për rregullimin dhe realizimin e procesit të optimizimit. Procesi i transferimit gradual të ofruesve të AFP-së, pritet të nisë zbatimin gjatë vitit 2021.

B. Diversifikimi i ofertës në Formim Profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës

Me qëllim rritjen e cilësisë së programeve të kurseve afatshkurtra për formim profesional, të cilat ofrohen nga Qendrat Publike të Formimit Profesional, AKPA ka ndërmarrë një sërë masash:

Në periudhën 2018-2020, janë hartuar nga AKAFPK dhe kanë nisur zbatimin 35 kurrikula (26 për kurse të unifikuara dhe 9 kurse të veçanta). Me mbështetjen e GIZ, si dhe në bashkëpunim me AKAFPK, referuar metodologjisë së hartimit të kurrikulave brenda vitit 2019, u punuan 10

kurrikula në nivel ofruesi, të cilat u vunë në zbatim në fillim të vitit 2020. Ky proces u mentorua nga ekspertë të fushës.

Në 6 mujorin e parë të vitit 2020, grupet e punës me koordinatorët e zhvillimit të kurikulave në DROFPP, u realizua rishikimi i 28 programeve të kurseve në nivel ofruesi dhe hartimi e tyre sipas metodologjisë përkatëse. Me mbështetjen e GIZ, rishikimi i programeve të këtyre kurseve u mentorua nga ekspertët e kontraktuar për këtë qëllim, duke finalizuar kështu procesin e rishikimit të kurikulave të zbatuara deri më tani në DROFPP.

Në kuadër të gjendjes së emergjencës kombëtare të krijuar nga pandemia e COVID- 19, në muajin tetor 2020, në bashkëpunim me GFA, AKPA rishikoi kurrikulën Start Smart duke përfshirë masat anticovid dhe gjithashtu u realizua trajnimi i TOT-ve për zbatimin e saj.

Në zbatim të projektit Proseed, si dhe në bashkëpunim me kompaninë Key Adviser LTD e cila është kontraktuar nga GIZ, në muajin korrik 2020 nisi të hartohet/ përpunohej kurrikula për aftësitë digjitale për punëkërkesit. Kjo kurrikul bazohet në karakteristikat dhe nevojat e target grupit, aftësitë digjitale sipas EU – Digicom dhe do të realizohet në një panel më të gjerë partnerësh (UNDP, GFA), me të cilat AKPA bashkëpunon për realizimin e aktiviteteve të parashikuara për arritjen e objektivave strategjik. Kurrikula është përfunduar dhe pritet që të dakordësohet me përfaqësues të AKPA-s dhe me mësimdhënësit e formimit teorioko-praktik në të gjitha QFP Publike në vend.

Bazuar në listën të kurseve tashmë të rishikuara apo të hartuara rishtazi që ofrojnë DROFPP, duke përfshirë edhe kriteret e pranimit në kurse formimi profesional pjese e kurikulave, është finalizuar matrica referuese e sistemit e-albania ku mbështetet procedura e aplikimit online për kurs formimi profesional.

Gjatë vitit 2020, me qëllim rregullimin e procedurës së përditësimit të ofertës, bazuar ne VKM nr.198 /2015, AKPA ka vijuar punën për hartimin e protokollit për hapjen e një kursi të ri në të gjitha drejtoritë e formimit profesional publik në Shqipëri, për të siguruar plotësimin e nevojave të tregut të punës për kualifikime profesionale. Protokollin synon të unifikojë procesin dhe hapat e hapjes së një kursi të ri në një nga 10 DROFPP dhe u zhvillua në një bashkëpunim shumë të ngushtë me stafin e GFA me një vizion të përbashkët për procedura të standardizuara dhe mundësi për të ofruar kurse me cilësi të lartë që përmbushin nevojat për aftësi të tregut rajonal të punës.

Prandaj protokollin përqëndrohet në të gjitha hapat që duhen ndjekur kryesisht nga stafi menaxhues i DROFPP, por edhe palët e tjera të interesit zbatuese, siç janë ZRAKPA / Bordi i DROAFP, përkatësisht:

- a) Identifikimin e vazhdueshëm të nevojave për kurse të reja në rajon në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Punësimit dhe Biznesin, si dhe i prioritizimin e tyre në përputhje me rëndësinë e kualifikimit përkatës në zhvillimin e tregut rajonal të punës, si dhe numrin e pritshëm të aplikantëve për këtë kurs.
- b) Verifikimin e kapacitetet infrastrukture dhe njerëzore për hapjen e kursit
- c) Konfirmimin në bord propozimin për hapjen e kursit dhe dërgimin në AKPA të kërkesës për miratimin e hapjes së kursit.

Ky proces do të mbështetet në urdhërat, rregulloret, manualët e punës të hartuara dhe të miratuara për këtë qëllim, si dhe indikatorët sasiorë dhe cilësorë të kartës së performancës. Sa më sipër në bashkëpunim me GFA protokollin dhe të gjitha metodologjitë e nevojshme janë finalizuar.

Metodologjia e llogaritjes së kostos për kurrikulat është një pjesë e Protokollit për hapjen e kurseve të reja të formimit profesional në DROFPP. Puna për metodologjinë e llogaritjes së kostos u zhvillua nga Agjencia në bashkëpunim me GFA dhe vijoi me pilotimin e saj në 7 QFP, përkatësisht; DRFPP Tiranë nr 1, Durrës, Korçë, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Vlorë për kursin e kuzhinës. Me qëllim finalizimin e këtij procesi dhe vijimin më tej me kurrikulat në nivel ofruesi tashmë të rishikuara dhe të validuara, gjatë vitit 2020 është ngritur një grup pune i dedikuar.

Infrastruktura, investimet në Ofruesit Publik të AFP-së

Një tjetër element i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së mësimdhënies në ofruesit publik të AFP-së janë investimet në infrastrukturë. Në këtë kuadër, AKPA ka ndjekur dhe monitoruar të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2020 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe me mbështetjen e donatorëve.

Në zbatim të projektit PROSEED është kryer investim në 5 kabinete të reja për kurset profesionale në DROFPP Tiranë nr.4, Tiranë nr.1, DROFPP Vlorë dhe DROFPP Fier, si dhe në 2 klasa start smart në secilën qendër së bashku me infrastrukturën informatike.

Në vijim, gjatë vitit 2020, është ndërhyrë përmes rikonstruksionit në 4 shkolla, përkatësisht: “Thoma Papapano” Gjirokastrë, “Mihal Shahini” në Cërrik, “Stiliano Bandilli” në Berat dhe “Salih Ceka” në Elbasan përpara fillimit të vitit të ri shkollor. Gjithashtu, ka përfunduar kolaudimi

për shkollat: “26 Marsi”, Kavajë, Shkolla “Teknike Ekonomike”, Tiranë, si dhe për shkollën “Beqir Çela”. Shkolla 26 Marsi është marrë në dorëzim dhe tashmë mësimi zhvillohet normalisht në ambientet e rikonstruara.

Në kuadër të rikonstruksionit të shkollave profesionale gjatë vitit 2020, me mbështetjen e UNDP Albania, është mundësuar rikonstruksioni i shkollës Hysen Çela, Durrës.

Me mbështetjen dhe financimin e GIZ Albania, gjatë vitit 2020 ka përfunduar miratimi i projektit për investime në infrastrukturë dhe kabinete në shkollën e mesme profesionale Kamëz. Ky investim parashikon ngritjen e një godine të re në mjediset e oborrit aktual të kësaj shkolle, shtimin e klasave dhe Workshopeve të drejtimit SHMT (Shërbime në Mjete të Transportit). Projekti pritet të rrisë kapacitetet infrastrukturore të kësaj shkolle, duke ofruar një mësimdhënie më cilësore dhe bashkëkohore ndaj nxënësve dhe stafit mësimdhënës.

C. Ristrukturimi dhe Menaxhimi i burimeve njerëzore pranë DRFPP-ve

Me miratimin e strukturës së re të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe e ofruesve publik të AFP-së, AKPA ka vijuar me procesin e riorganizimit të institucioneve të varësisë, përfshirë këtu edhe Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik. Në funksion të këtij procesi, është ngritur komisioni i ristrukturimit, i cili hartoi kriteret e vlerësimit të propozimeve të ardhura nga ofruesit e FP; ai dhe përmes verifikimit të propozimeve me dosjet e personelit aktual në DROFPP u hartua vendimi i komisionit të ristrukturimit për 10 QFP-të. Gjatë vitit 2020, ka vijuar ndjekj e hartimit të emërimeve dhe lirimeve nga detyra të stafeve përkatëse në kuadër të këtij procesi.

D. Sistemi informatik për Qendrat e Formimit Profesional dhe Menaxhimi i të dhënave administrative/ statistikave zyrtare të AFP-së

Një prej prioriteteve të AKPA në fushën e AFP-së është ngritja e një sistemi të integruar të menaxhimit të informacionit. Në kwtw kontekst në bashkëpunim me Projektin “Aftësi për Punë” është krijuar dhe pilotuar në 3 QFP gjatë vitit 2019, sistemi informatik për Qendrat e Formimit Profesional.

Gjatë vitit 2020, sistemi i menaxhimit të Ofruesve Publik të Formimit Profesional është dorëzuar zyrtarisht nga kompania zhvilluese tek porositësit dhe financuesit e platformës, në këtë rast tek projekti S4J. Menjëherë pas marrjes në dorëzim të sistemit, AKPA planifikon shtrirjen e këtij sistemi në të gjithë DROFPP-të.

Në kuadër të marrjes në dorëzim, sistemi është ripilotuar në 3 DRFPP, përkatësisht; DRFPP nr.1, DRFPP nr. 4 në Tiranë si dhe DRFPP Vlorë.

Sa i përket këtij procesi, AKPA ka kërkuar mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dhe pjesëmarrjen me përfaqësues në grupin ndërinstitucional të punës që do të ngrejë Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë qëllim, me qëllim planifikimin sa më të mirë të burimeve financiare, infrastrukturore dhe njerëzore për shtrirjen e këtij sistemi në të gjithë DROFPP-të dhe më pas zhvillimin e mëtejshëm dhe mirëmbajtjen e tij.

Me qëllim unifikimin e sistemit të menaxhimit të informacion të AFP-së për të gjithë ofruesit, ka nisur zbatimin e asistencës teknike IPA II, i cili synon ndërtimin e një modeli të unifikuar për menaxhimin e informacionit të AFP-së dhe pritet të shtrihet në dy vitet e ardhshme.

Me mbështetjen e projektit S4J, AKPA në fund të vitit 2020, ka filluar punën për të mundësuar krijimin e një aplikacioni për sigurimin e të dhënave administrative/ statistikave zyrtare të AFP-së, i cili do të përdoret nga përfaqësues të MFE, AKAFPK si dhe grupeve të tjera të interesit. Aplikacioni është zhvilluar duke ofruar zgjidhje lidhur me:

- Menaxhimin më eficient i procesit të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave
- Rritjen e saktësisë së të dhënave të mbledhura
- Prodhimin e raporteve automatike sipas nevojave të përdoruesve (në nivel shkolle apo sistemi)
- Vizualizimin dhe rritjen e përdorimit të të dhënave për qëllime manaxheriale; përmes lidhjes me websitet e shkollave/ AKPA, ndarja e rezultateve të shkollave me palë të treta në kohë reale,
- Mbledhjen e të dhënave ‘ad hoc’ dhe prodhimin e raporteve sipas nevojave
- Modulet, duke mundësuar krijimin e 5 moduleve: 1) moduli i nxënësit, 2) moduli i kursantit, 3) moduli i mësuesit, 4) moduli i biznesit dhe 5) moduli i infrastrukturës.

Kartelat e të dhënave për 4 modulet janë riformatuar, me qëllim mbulimin e të gjithë nevojave të konstatuara për statistika dhe është në përfundim kartela e pestë (infrastruktura).

Aktualisht, është siguruar, validuar dhe riformatuar sipas kërkesave të aplikacionit, regjistri i të dhënave për nxënësit për vitet 2019-2020 dhe 2020-2021, si dhe për kursantet për vitet kalendarike 2019 dhe 2020, me qëllim që këto të dhëna të kenë një historik të paktën dy vjeçar. Me miratimin e aplikacionit të dhënat do të importohen automatikisht në sistem.

Për vitin e ardhshëm, do të vijojë puna për rishikimin e raporteve dhe vizualizimin e të dhënave, si dhe parashikohet të vijohet me trajnimin e stafit të ofruesve të AFP-së për të hedhur të dhënat e munguara dhe ndjekjen e procesit të popullimit të sistemit.

E. Monitorimi, Vlerësimi dhe Licencimi i Ofruesve Privat të Formimit Profesional

Në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të ofruesve privat të formimit profesional, gjatë vitit 2020, janë shqyrtuar dhe ndjekur 147 procedura/ kërkesa për licencim për formim profesional, nga të cilat, pas shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues të subjekteve, si dhe verifikimit fizik të kushteve paraprake të licencimit është dhënë vlerësimi përkatës, si më poshtë:

- 94 kërkesa janë vlerësuar pozitivisht në përmbushje të kriterëve paraprake të licencimit.
- 53 kërkesa janë vlerësuar negativisht, për mospërmbushje të kushteve paraprake të licencimit, më së shumti, për mospërshtatshmëri të aftësive të drejtuesit didaktik me kurset që ofrohen dhe mungesë ekseprience punë në kurset për të cilat ofrohen.

Gjatë vitit 2020, pranë AKPA paraqitur 95 kërkesa të subjekteve private për ofrim të kurseve për formim profesional, të cilat kategorizohen si më poshtë:

- 24 kërkesa për kurset për mësimdhënien e gjuhëve të huaja (anglisht, italisht, gjermanisht);
- 38 kërkesa për kurse në fushën e Parukeri- Estetikës;
- 12 kërkesa për kurse në fushën e IT dhe të Teknologjisë së Informacionit (Kompjuter, bazat kompjuterike, programim në IT, software etc);
- 8 kërkesa për ofrim e kurseve në fushën e kulinarisë (kuzhinë, picajol, pasticeri etj)
- 7 kërkesa për kurse në fushën e financës dhe ekonomisë dhe kontabilitetit;
- 6 kërkesa në fushën e përkujdesit social; etj

Në kuadër të shqyrtimit të kërkesave të subjekteve private për Licencë “Arsim të Mesëm Profesional” në Kodin IX.1.A.6 dhe Licencë për “Arsim i Mesëm Teknik”, në Kodin IX.1.A.7,

është trajtuar vetëm një kërkesë, e cila u refuzua për shkak të mospërmbushjes së kriterëve për zhvillimin e aktivitetit në ambient.

F. Monitorimi i subjekteve private të licencuara për formim profesional

Në zbatim të pikës 3, të Formularit të Deklarimit të Posaçëm të Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe të Pikës 17 gërmat “a” dhe “b” të Udhëzimit Nr. 1457, datë 28.7.2009, “*Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional*”, i ndryshuar, gjatë vitit 2020, 146 subjekte private të licencuara sipas Formularëve 1 & 2 kanë deklaruar të dhënat e kursantëve të çertifikuar sipas kurseve të ndjekura.

Nga ky deklaram rezultojnë: 102 subjekte private në qytetin e Tiranës, 5 subjekte të Lezhës, 1 subjekt nga qyteti i Kavajës, 7 subjekte nga qyteti i Shkodrës, 4 subjekte nga qyteti i Vlorës, 1 subjekt nga qyteti i Krutës, 2 subjekte nga qyteti i Durrësit, 1 subjekt nga qyteti i Lushnjës dhe 1 subjekt nga Malësia e Madhe, 1 nga Gjirokastra, 1 nga Saranda. Nga të dhënat deklarimeve sipas formularëve Nr.1 dhe Nr 2 të paraqitura deri tani për vitin 2020, konkludojmë në këto rezultate: Nga 146 subjekte të licencuara, 116 ushtrojnë aktivitetin në qytetin e Tiranës. Të dhënat flasin për të trajnuar në total, 7620 të trajnuar (90% e tyre në subjektet e Tiranës). Karakteristika e te trajnuarve janë si vijon:

- 50 % femra;
- 36 % të papunë;
- 40.5% të grupmoshës 16-24 vjeç
- 41 % të grupmoshës 25-34 vjeç
- 18.4 % janë të grupmoshës mbi 34 vjeç
- 8.9 % me nivel arsimor të ulët
- 44 % me nivel arsimor të mesëm
- Rreth 46.9 % me nivel arsimor të lartë.

Nga të dhënat e deklaruara, kurset më të frekuentuara gjatë vitit 2020 janë:

- Gjuhët e huaja (Angleze, Gjermanisht, Italisht, Frengjisht, Arabisht, Spanjisht) me 2641 kursantë, në 25 subjekte;

- Në fushën e Parukeri-Estetikës (Parukeri, Estetikë, Ndërtim Thonjsh- Manikyr- Pedikyr, Vetulla) 671 kursantë, në 57 subjekte.
- Në fushën e kuzhinës dhe hotelerisë (shef kuzhine, ndihmës kuzhinier, pastičier, picajol, prodhim brumi, barist, menaxher bari, menaxher hoteli) 698 kursantë, në 9 subjekte;
- Në fushën ekonomike (Financa 5, Kontabilitet Praktik, i Përgjithshëm Ekonomiko-Financiare, Kontabilitet dhe fiskalitet të aplikuara) janë trajnuar 895 kursantë nga 5 subjekte;
- Në fushën e IT dhe gjuhëve të programimit, sigurisë kibernetike etj janë trajnuar 398 kursantë në 14 subjekte private.

G. Aplikimet online për Regjistrim në Kurse Formimi Profesional nëpërmjet Portalit e-Albania

Në zbatim të Urdhër Nr.158, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online”, çdo qytetar aplikon nëpërmjet faqes zyrtare e-albania për të marrë informacionin e duhur lidhur me shërbimin e Regjistrimit në Kurse Formimi Profesional.

Në këtë kuadër, përmes sistemit AMS, AKPA kryen monitorimin e kërkesave të qytetarëve për “Aplikim për regjistrim në kurse formimi profesionale” në nivel institucional, rajonal, si dhe në koordinim me Zyrën e Punës që administrojnë aplikimet e punëkërkuesve të papunë për kurse formimi.

Tabela në vijim paraqet numrin e aplikimeve për kurse formimi profesional gjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020:

	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Aplikime të ardhura për regjistrime	261	98	77	62	414	416	740	597	655	452

KAPITULLI V- PROMOVIMI I PËRFSHIRJES SOCIALE DHE I KOHEZIONIT TERRITORIAL

A. Vlerësimi i nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit në zonat e pambuluara.

Në Dhjetor të vitit 2018 midis ish-Shërbimit Kombëtar të Punësimit (sot AKPA) dhe ADISA-s është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi e cila synonte rregullimin dhe legjitimimin e bashkëpunimit reciprok në përmbushje të detyrimeve ligjore të ndërsjellta në ofrimin e shërbimeve të sportelit të SHKP-së (sot AKPA) nga sportelet e ADISA-s, sipas parimit të ndarjes së Zyrave Pritëse nga Zyrat Përgjegjëse për shërbimin.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 SHKP (sot AKPA) ka ndërmarrë nismën për nënshkrimin e marrëveshjeve me Njësitë e Qeverisjes Vendore në kuadër të forcimit dhe bashkërendimit të politikave të punësimit në nivel rajonal dhe vendor.

Këto marrëveshje konsistojnë në ndërtimin e një marrëdhënieje dypalëshe me qëllim shërbimin e institucionalizuar dhe ndihmën ndaj punëkërkesve për një jetë më të mirë dhe dinjitoze, si dhe në koordinimin e përpjekjeve institucionale në nivel vendor dhe rajonal nën objektivin kryesor të uljes së nivelit të papunësisë në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dhe adresimin sa më efektiv të problematikave sociale me të cilat përballen individët.

Për sa më lart, gjatë vitit 2019 janë realizuar 4 marrëveshje bashkëpunimi; përkatësisht, a) me Bashkinë Maliq, b) Bashkinë Korçë, c) Bashkinë Fier dhe ç) Bashkinë Delvinë.

Gjatë vitit 2020, është nënshkruar marrëveshja me Bashkinë Elbasan ndërkohë që janë draftuar dhe dërguar për nënshkrim edhe 3 marrëveshje të tjera, për Bashkinë Tiranë, Berat, Durrës dhe Lezhë.

Në kuadër të procesit të optimizimit është finalizuar analiza për rishpërndarjen e ofruesve aktualë të AFP sipas zonave gjeografike që aktualisht mbulohen. Pas finalizimit të këtij procesi, do të nis vlerësimi i nevojave për shërbime të formimit në zonat e pambuluara.

Në kuadër të vlerësimit të nevojave për shtrirjen e shërbimeve të punësimit në zonat e pambuluara, gjatë vitit 2020, AKPA ka realizuar një sërë takimesh me Agjencinë Franceze të Ekspertizës Ndërkombëtare Teknike dhe Pole Emploi me qëllim mbështetjen e institucionit për përmbushjen

e këtij objektivi strategjik. Përmes Asistencës Teknike (IPA) që planifikohet të zbatohet, AKPA synon të adresojë çështjet sa më poshtë vijojnë:

- Forcimi i qasjes së grave në tregun e punës duke dizenuar paketa të ofrimit i shërbimeve të punësimit duke targetuar gratë në zonat e pambuluara dhe në zonat rurale. Ky komponent pritet të jetë i dedikuar Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
- Ofrimi i informacionit të arritshëm për të drejtat e grave, përmes fushatave promovuese, por edhe ëorkshop-eve të zhvilluara në terren me grupin e synuar.
- Mbështetje ndaj grave për mundësinë e gjenerimit të të ardhurave me qëllim përmirësimin ofertës së kujdesit për fëmijët, duke ofruar mbështetje edhe në përmirësimin e këtyre shërbimeve në nivel kombëtar.

B. Rritja e aksesit për shërbime të punësimit dhe të AFP-së për grupet e veçanta.

Në sistemin e ri të shërbimeve të punësimit është përcaktuar përgatitja e Planit Individual të Punësimit për çdo punëkërkuar të papunë të regjistruar. Në vitin 2020 u përgatitën udhëzuesit që lidhen me këtë proces. Nga vlerësimi që i bëhet punëkërkuarit të papunë nga këshilluesi përcaktohen edhe paketat e shërbimeve të cilat i përshtaten atij me qëllim riintegrimin në tregun e punës. Gjithashtu, nëse konstatohet se për një punëkërkuar të papunë ekzistojnë pengesa të tjera si këshillime të specilaizuara, mungesa e kopshteve dhe çerdheve etj., në sistem është parashikuar edhe referimi i tyre në OJF ose njësitë e qeverisjes vendore. Në këtë rast punëkërkuar i papunë merr statusin pezull.

Me qëllim rregullimin e sistemit të referimit, AKPA në bashkëpunim me UNDP ka hartuar një Udhëzues për menaxhimin e integruar të rastit ZP& NJVNR. Ky Udhëzues synon hartimin dhe pilotimin e një modeli të menaxhimit të integruar të rastit (MIR) mes dy shërbimeve, për t'iu përgjigjur mes përfituesve të ndihmës ekonomike (NE), atij grupi përdoruesish të shërbimit me nevoja shumëfishe psiko-sociale dhe shëndetësore, të cilët kanë nevojë për një qasje individuale intensive, për të siguruar fuqizimin dhe lehtësimin e integritit të tyre në tregun e punës.

Në lidhje me rritjen e aksesit në AFP të grupeve të veçanta, në të gjitha rikonstruksionet e infrastrukturës së ofruesve të realizuara në vitet e fundit, është realizuar përshtatja e ambjenteve

për nxënësit/ kursantët me aftësi të kufizuar. Gjithashtu, është miratuar kurrikula për gjuhën e shenjave dhe pritet të nis trajnimi i instruktorëve të parë të cilët do të japin këtë kurrikul.

C. Hartimi i skemës riintegruese në tregun e punës të përfituesve të skemës së Ndhmës Ekonomike

Gjatë intervistimit dhe vlerësimit të punëkërkuessit të papunë nga këshilluesit në Zyrat e Punësimit, mund të rezultojë se punëkërkuessi i papunë (zakonisht grupet vulnerabël si NE dhe grupe të tjera) nuk mund të punësohet për shkak të ekzistencës së disa pengesave të tjera të cilat mund të zgjidhen prej bashkive dhe institucioneve të tjera. Në raste të tilla, pu.pa merr statusin pezull dhe referohet në institucionin apo OJF-në përkatëse.

Me qëllim rregullimin e sistemit të referimit, AKPA në bashkëpunim me UNDP ka hartuar një Udhëzues për menaxhimin e integruar të rastit ZP& NJVNR (si më sipër).

Bashkëpunimi për riintegrimin në tregun e punës të kategorisë NE dhe ish NE

Marrëveshja midis AKPA-s dhe Shërbimit Social Shtetëror të nënshkruar për ri-integrimin në tregun e punës të përfituesve aktualë dhe ish të ndihmës në para, për vitin 2020, dha si rezultat:

- Punësimin e 455 përfituesve të mëparshëm dhe 1,374 përfituesve;
- Pjesëmarrjen e 62 përfituesve të mëparshëm dhe 165 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;
- Pjesëmarrjen e 43 përfituesve të mëparshëm dhe 170 përfituesve në kurse të formimit profesional.

KAPITULLI VI- FUQIZIMI I QEVERISJES SË TREGUT TË PUNËS DHE I SISTEMIT TË KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

A. Krijimi i AKPA si institucion përgjegjës për administrimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave të punësimit dhe menaxhimit të ofruesve publike të AFP -së

Struktura e re e miratuar e Agjencisë, në Drejtorinë e Përgjithshme ka parashikuar një staf prej 90 personash nga 36 që kishte struktura e mëparshme. Plotësimi i stafit ka filluar pas miratimit të kësaj strukture.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, procesi i plotësimit të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të AKPA nisi gjatë muajit Qershor 2020. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pas procesit të ristrukturimit të stafit ekzistues në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike vijoi me procedurat e rekrutimit për plotësimin e vendeve vakante të planifikuara për vitin 2020.

Procesi i ristrukturimit të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik.

Gjithashtu gjatë vitit 2020, me hyrjen në fuqi të ndryshimit të Urdhërit të Kryeministrit nr.172 datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka mbyllur procedurat e ristrukturimit të Drejtorive Rajonale të AKPA dhe Drejtorive Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik. Ristrukturimi u bazua mbi parimin e optimizimit të burimeve njerëzore dhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor. Synimet kryesore të këtij ristrukturimi lidhen me ndarjen e roleve dhe përgjegjësi, profilizimin e qartë të punonjësve, optimizimin e punës dhe ofrimin e një shërbimi adekuat për punëdhënësit dhe punëmarrësit. Shërbimet janë pjesa më e prekshme që konkretizojnë zbatimin e politikave të punësimit ndaj ofrimi i shërbimeve cilësore mbetet një ndër prioritetet kryesore të AKPA. Ofrimi i një shërbimi cilësor korrelohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmirësimin e treguesve të punësueshmërisë. Gjatë procesit të ristrukturimit, një vëmendje e veçantë iu kushtua

profilin arsimor që duhet të kishte pozicioni i punës në formë të tillë që ai të ndërlidhet me aftësitë e nevojshme për ushtrimin e tij në mënyrë profesionale. Specifikat/profili arsimor që duhet të përmbajë pozicioni i punës për secilin prej pozicioneve dhe shërbimeve të ofruara u unifikuuan për të gjitha drejtoritë rajonale.

Komisionet e Ristrukturimit gjatë procesit të restrukturimit gjithashtu shqyrtuan mundësinë e sistemimit të çdo punonjësi në vendet e lira ekzistuese apo transferimin e punonjësve në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori. Ky proces është finalizuar në muajin Nëntor 2020.

B. Staf i trajnuar sipas funksioneve dhe përgjegjëse të AKPA si dhe për aplikimin dhe menaxhimin e projekteve të financuara nga programet e BE-së

Në kuadër të trajnimit të stafit të AKPA pas finalizimit të procesit të restrukturimit në të gjitha nivelet, në përputhje me funksionet e reja të Agjencisë dhe menaxhimit të projekteve të financuara nga projektet e BE-së, janë ndërmarrë aktivitetet si më poshtë:

- Në muajin dhjetor 2020, në vijim të organizimit të TAIEX dhe binjakëzimit me institucione të BE-së me qëllim shkëmbimin e ekperiencave gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, AKPA zhvilloi ëorkshopin 2 ditor në bashkëpunim me VDAB, Bruksel. Qëllimi i ëorkshop-it ishte shkëmbimi i ekperiencave mbi masat e ndërmarra në ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional gjatë periudhës së pandemisë. Ëorkshopi u nda në dy seksione kryesore, përkatësisht: a) ofrimi i shërbimeve të punësimit dhe b) ofrimi i shërbimeve të formimit profesional.
- Gjatë këtij ëorkshop-i morën pjesë të gjithë nëpunësit e angazhuar në Drejtorinë Qendrore të AKPA me qëllim marrjen e praktikave me të mira europiane për ofrimin e APLMP dhe shërbimeve të AFP-së.
- Në muajin Maj 2020, në kuadër të programit të EaSI-it të financuar nga Bashkimi Europian, AKPA në bashkëpunim me UNDP Albania ka nisur zbatimin e projektit “Mbështetje për Mësimin e Vazhduar të të Papunëve” (SCUL). Projekti synon trajnimin e punëkërkuesve pak ose aspak të arsimuar dhe kualifikuar që janë të regjistruar pranë

AKPA-s. Në vitin 2021, projekti planifikohet të vijojë me analizën e target grupit, implementimit të platformës së vlerësimit të aftësive dhe rritjen e kapaciteteve të AKPA, për tu shtrirë më tej në vitin 2022.

- Gjatë vitit 2020, në kuadër të Asistencës Teknike IPA II, AKPA ka nisur fazën e implementimit të projektit. Një nga rezultatet kryesore të asistencës, si për komponentin e punësimit, ashtu edhe për formimin, është rritja e kapaciteteve të stafit të AKPA në nivel qendror dhe rajonal. Aktualisht, AKPA ka rialokuar nevojat për mbështetje dhe projekti është në fazë shkrimi të inception report-i. Në vitin e ardhshëm, pritet miratimi i ndryshimeve të propozuara dhe nisja e zbatimit të projektit.
- Gjatë vitit 2020, me mbështetjen e Seisscontact është realizuar trajnimi i stafit të drejtorive rajonale dhe zyrave vendore për këshillimin e punësimit dhe të shërbimeve të tjera të punësimit të miratuara gjatë këtij viti, si dhe funksioneve të reja në përputhje me strukturën e re të Agjencisë.

C. Forcimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të politikëbërjes në sektorin e punësimit dhe të AFP-së

Gjatë vitit 2020, u hartua manuali i proceseve të punës për DRAKPA-t, mbi të cilin u përcaktuan treguesit e monitorueshëm për Punëkërkesit dhe Punëdhënësit. Gjithashtu, nisi edhe përgatitja e manualit të proceseve të punës për ofruesit e AFP-së. Bazuar mbi këtë manual, do të përcaktohen dhe treguesit e monitorueshëm të ofruesve të AFP-së për vitin 2021.

D. Fuqizimi i dialogut social për kontratat kolektive dhe mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve

Gjatë vitit 2020 AKPA ka hartuar dhe miratuar formatin standard të kontratave kolektive që rregullojnë marrëdhëniet midis agjencisë dhe njësisë vartëse dhe Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë. Kontrata është vënë në dispozicion të gjithë stafit të AKPA në nivel qendror dhe rajonal. Databaza kombëtare është ngritur dhe pritet të popullohet dhe bëhet funksionale me vënie në funksion të plotë të sistemit të ri. Rrjeti i ndërmjetësimit është ngritur dhe në çdo zyrë njëri prej

punonjësve është përgjegjës për ndërmjetësimin. Për shkak të ristrukturimit gjatë vitit 2021, do të behët përditësimi i listës së personave përgjegjës për ndërmjetësimin. Në sistemin e ri të shërbimeve të punësimit mosmarrëveshjet janë pjesë e modulit të punëdhënësit në formën e një regjistri të thjeshtë.

E. Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi kombëtar të Informacionit të Tregut të Punës dhe AFP-së

Sistemi i ri informatik i shërbimeve të punësimit është parashikuar të marrë të dhëna nga DPT, QKB, Gjendja Civile, sistemi i SHSSH-së etj. Sistemi i ri informatik është konceptuar me 12 module nëpërmjet të cilëve do të rritet shkalla e aksesueshmërisë dhe ndërveprimit ndërmjet punëdhënësve dhe punëkërkuësve të papunë si dy klientët kryesorë të zyrave të punësimit. Po ashtu si pjesë integrale e sistemit të ri është parashikuar dhe vënia në funksion e portalit i cili do të jetë një burim i vazhdueshëm informacioni për një ndërlidhje sa më efektive të kërkesës dhe ofertës. Në portal është parashikuar të publikohen të gjithë vendet e punës si dhe ofrohet mundësia që punëkërkuësit të regjistrojnë të dhënat e tyre në mënyrë që të informohen në mënyrë të vazhdueshme për ofertat e tregut të punës. Gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i sistemit lidhet me mundësinë e realizimit të analizave të tregut të punës dhe të përmirësimit të politikave/planeve të punësimit mbi bazën e këtyre analizave.

Për ofruesit e AFP-së, është ndërtuar Sistemi i Menaxhimit të Ofruesve Publik të Formimit Profesional (SMQFP). Gjithashtu, po finalizohet aplikacioni i menaxhimit të të dhënave administrative të arsimit dhe formimit profesional. Sapo ky aplikacion të finalizohet dhe të popullohet me të dhëna, do të nis gjenerimi i statistikave të arsimit të mesëm profesional, si pjesë e programit Statistikor të AKPA.

Çdo vit SHKP (sot AKPA) ka publikuar Buletinin Statistikor vjetor. Gjithashtu, në zbatim të Strategjisë së Sistemit Kombëtar Statistikor, prej vitit 2021 AKPA do të publikojë kalendarin vjetor të statistikave të publikueshme, dhe statistikave të publikueshme 3 mujore. Pjesë e këtyre statistikave do të jenë edhe statistikave të shkollave të mesme profesionale.

KAPITULLI VII- TRANSPARENCA, KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

A. Imazhi i ri Institucional

Me riorganizimin institucional, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, ka ndërmarrë fushata për përditësimin e të dhënave dhe ndryshimin e emrit zyrtar. Fushata është shtrirë edhe në nivelin e institucioneve të varësisë. Pamja e këtyre institucioneve në profilet zyrtare është unifikuar duke u prezantuar qartë si institucione të AKPA. Më tej, puna ka vijuar çdo ditë duke përditësuar faqen, duke publikuar aktivitete, duke pasqyruar në kohë reale çdo aktivitet të shpërndarë të lidhur me fushën e përgjegjësisë së AKPA, nga MFE, KM apo bashkëpunorët tanë. Ëeb- faja ofron tashmë një dizajn të ri, më miqësor në përdorim, si dhe informacion, video dhe galeri të përditësuara. Link-u WEB i AKPA: <http://akpa.gov.al/>

B. Publikimi i Vendeve të lira të Punës (VLP)

Sa i përket publikimit të vendeve të lira të punës (VLP) së Administratës Publike, gjatë vitit 2020, janë publikuar rreth 512 shpallje për VLP, të ardhura nëpërmjet adresës së email- it, në mënyrë zyrtare, si dhe përmes faqes zyrtare të ëeb-it të institucionit. Kërkesat e adresuara publikohen në portalin zyrtar të AKPA dhe numërohen mesatarisht rreth 15-20 të kërkesa për publikim në ditë.

C. Promovimi i rasteve të suksesit

AKPA, sa i përket angazhimit në fushatat promovuese, ka në fokus evidentimin dhe promovimin e rasteve të suksesit të punëkërkuesve të papunë që integrohen në tregun e punës përmes procesit të ndërmjetësimit që administrohet nga Zyrat e Punës. Gjithashtu, në kuadër promovimit të rëndësisë dhe mundësive të ofruara nga sistemi i AFP-së, çdo javë në faqen zyrtare të AKPA, si dhe në faqen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë publikuar 1-2 raste sukcesi ose dëshmi personale nga një nxënës në Arsim Profesional, ose kursant në Formim Profesional. Gjatë

vitit 2020, me qëllim informimin e publikut dhe rritjen e imazhit të AFP-së, janë zhvilluar aktivitetet sa më poshtë vijon:

- Gjatë periudhës së regjistrimeve në shkollat e mesme profesionale, me mbështetjen e projektit “Aftësi për Punë” (S4J) janë realizuar 18 video promovuese për Shkollat e Mesme te Arsmimit Profesional dhe DRFPP, të cilat janë promovuar në faqen e Ministres së Financave dhe Ekonomisë dhe në të gjitha rrjetet sociale të AKPA, Zyrave të Punësimit, DRFPP-ve dhe Shkollave të Mesme të AP.
- AKPA në bashkëpunim me MFE, ka realizuar 25 video promovuese, si dëshmi suksesi e edukimit dhe formimit të marrë pranë shkollave profesionale apo Qendrave të Formimit Profesional, të cilat u kanë mundësuar atyre punësim, ose certifikim të njohurive për vijimin e marrëdhënieve të punës. Këto video janë shfaqur periodikisht ne faqen zyrtare te AKPA dhe rrjetet sociale të dedikuara.
- Me mbështetjen e UNDP Albania është realizuar fushata “Gjenerata R”, e cila përmban video promovuese dëshmi të nxënësve që ndjekin arsimin profesional për ekperiencat e tyre të marra nga ofruesit. Përmes këtyre komunikimeve, të rinjtë ftojnë bashkëmoshatarët e tyre për të vlerësuar nga një këndvështrim tjetër rinor dhe frymezues rëndësinë e rrugës drejt AP. Videot promovuese janë publikuar përmes rrjeteve sociale të agjencisë, facebook, instagram, pinterest dhe youtube. Është realizuar publikimi dhe prezantimi në rrjetet sociale të të gjithë institucioneve të varësisë në AKPA të vizitave të Ministres së Financave dhe Ekonomisë pranë shkollave dhe Qendrave të Formimit Profesional.

D. Menaxhimi i kërkesave të sistemit të qarkullimit të dokumentacionit me nënshkrim elektronik të kërkesave nga të tretët për AKPA

Gjatë vitit 2020, në sistemin e SQDNE-së janë adresuar mesatarisht 100 kërkesa , të cilat janë trajtuar, shqyrtuar dhe adresuar brenda afteve ligjore.

E. Menaxhimi i Sistemit të Ankesave në AKPA

Eshtë përfunduar nga ekspertet strategjia e Menaxhimit të sistemit të ankesave të institucionit dhe po ashtu është përgatitur udhëzimi përkatës i cili detajon rrjedhën e punës dhe mënyrën e procedimit.

Faza e Pilotimit

Prej datës 01.10.2020 Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun në AKPA nisi fazën e pilotimit. Dy specialist të AKPA janë ngarkuar me detyrën e ndjekjes së procesit.



Në një databazë manuale po mbahen rekordet e çdo ankese në drejtim të AKPA nga të gjitha kanalet e komunikimit.

KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBIKUN

AKPA 2020




Gjatë vitit 2020, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka trajtuar në total **931** kërkesa për informacion të drejtuar pranë adresës së kontaktit: *kontakt@akpa.gov.al*. Gjatë muajve *Janar- Qershor 2020*, nr. më i lartë i kërkesave për informacion të drejtuar pranë AKPA lidhen me ofrimin e shërbimeve në kuadër të situatës së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, siç janë; pagesë papunësie, regjistrim dhe vërtetim si Pu.Pa, si dhe përfitim i pagës së luftës. Ndërsa, gjatë muajve *Korrik- Dhjetor 2020*, me miratimin e Programeve të Nxitjes, si dhe rinisjen e pjeshme aktivitetit të shkollave dhe QFP-ve, kërkesat për informacion shfaqin një trend pozitiv ndaj shërbimeve të punësimit (+125%), shërbimeve të formimit profesional (3-fishim i kërkesave të adresuara krahasuar me 6-mujorin e I), si dhe Programeve të reja të Nxitjes së punësimit (2-fishim i kërkesave të adresuara krahasuar me 6-mujorin e I).



Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka vendosur në dispozicion të qytetarëve disa kanale komunikimi përmes të cilave mund të informojë dhe adresojë të gjitha kërkesat dhe ankesat në fushën e punësimit dhe aftësimin profesional. Shpërndarja e përdorimit të tyre nga qytetarët është:

- Adresa e kontaktit- rreth **68%**
- Platforma e Bashkëqeverisjes- rreth **29%**
- Rrjete Sociale (facebook)- rreth **2.8%**
- Nr. i kontaktit telefonik- rreth **0.2%**

100% e kërkesave dhe ankesave janë trajtuar brenda afateve ligjore.



AKPA, ndër të tjera, trajton kërkesat për informacion dhe ankesat që vijnë përmes Platformës së Bashkëqeverisjes. Gjatë vitit 2020, AKPA ka shqyrtuar, trajtuar dhe adresuar në total 398 kërkesa për informacion dhe ankesa. Rreth **97%** e tyre janë kërkesa për punësim nga punëkërkues të papunë.

Të gjitha rastet e mbërritura janë shqyrtuar me kujdes, duke i deleguar pranë Zyrave të Punës përkatëse, ose ofruar informacion për Programet e Reja të Nxitjes së Punësimit me qëllim integrimin e punëkërkuesve të papunë në tregun e punës.

Numri më i lartë i kërkesave për informacion dhe ankesave, siç tregohet në Fig. 1, vijnë nga rajonet më të mëdha në vend, si; Tirana, Shkodra, Durrësi, Fieri, Vlora, Korça, Elbasani, duke u pasuar nga qytete si Kukësi, Berati, Gjirokastra, etj.




Fig.1

KAPITULLI VIII- Lidhjet me projekte, programe dhe partnerë strategjikë



INSTRUMENT FOR PRE-ACCESSION ASSISTANCE (IPA II)- Asistenca Teknike për të Mbështetur Reformën në Politikat e Punësimit dhe Arsimin dhe Aftësimin Profesional

Objektivi i përgjithshëm i Asistencës Teknike për të Mbështetur Reformën në Politikat e Punësimit dhe Arsimin dhe Aftësimin Profesional është të kontribuojë në zbatimin e planit të veprimit NESS 2019 - 2022 përmes ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimit institucional në punësimin dhe shërbimet e AFP-së. Projekti është hartuar në dy komponentë:

- **Komponenti 1**, për të forcuar shërbimet e punësimit përmes një Modeli të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, hartimit të një Plani Kombëtar të Garancisë së të Rinjve dhe një Strategjie Komunikimi për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA).
- **Komponenti 2**, përmes një Modeli të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për sektorin e AFP-së, një plani kombëtar të zhvillimit të ofruesit të AFP-së dhe një plani të përgjithshëm të investimeve, dhe dizajnit të një MIS-i të AFP-së.



“Mbështetje për Mësimin e Vazhduar të të Papunëve” (SCUL)

Projekti “Mbështetje për Mësimin e Vazhduar të të Papunëve” (SCUL) është financuar nga **Programi EaSI** i Bashkimit Evropian dhe do të drejtohet e zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), në partneritet me UNDP Albania. Objektivat kryesorë të projektit janë: *a)* zhvillimi i aftësive bazike mësimore dhe digjitale të punëkërkuësve të papunë me kualifikim dhe edukim të ulët (lexim dhe shkrim), me qëllim që në vijim të mund të kenë qasje në tregun e punës, përmes punësimit të qëndrueshëm, si dhe në arsimin profesional/ programe të specializuara mësimore, *b)* ndërtimi i një strukture/ mekanizmi kombëtar, i cili synon që ti përgjigjet sistematikisht nevojave të punëkërkuësve me kualifikim të ulët, me qëllim që t'u ofrojë atyre mundësi zhvillimi sipas nevojave që paraqesin.



PROJEKTI C4EE

Qasja e projektit “Këshillim për punësim dhe sipërmarrje” filloi në vitin 2010 dhe ka vazhduar deri në 2020. “Coaching for Employment and Entrepreneurship” (C4EE) është një projekt i cili asiston të rinjtë që vijnë nga grupet vulnerabël, në rrugën e tyre drejt punësimit. Ciklet e trajnimit me pjesëmarrësit e rinj të papunë janë planifikuar të zbatohen në partneritet me OJQ-të e shoqërisë civile, Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe NVM-të, duke përfshirë trajnime në grup dhe individuale si dhe faza të ndryshme zhvillimi si ndërtimi i grupeve, eksplorimi i botës së punës,

praktika të shkurtra dhe të gjata, aktivitete komuniteti, kurse profesionale ose të mësuarit në punë, trajnime për aftësitë e jetës, planifikimin e një biznesi dhe / ose start-up-eve.

S4J “Skills for Jobs”

Projekti “Skills for Jobs” është ratifikuar përmes Ligjit Nr. 61/2017 dhe zbatohet nga Swisscontact. Objektivi i përgjithshëm i projektit është përfitimi i të rinjve në Shqipëri nga edukimi dhe trajnimet e përforcuara të orientuar drejt tregut të punës në sektorët me potencial në rritje, duke i mundësuar atyre gjetjen e një punë tërheqëse dhe dinjitoze. “Aftësi për Punë” (S4J) është një projekt me fokus inovacionin në Arsimin dhe Formimin Profesional dhe punësimin e të rinjve në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat. Projekti mbështet shkollat e mesme profesionale: “Hamdi Bushati” Shkodër, “Kolin Gjoka” Lezhë, “Gjergj Canco” Tiranë, Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë, “Tregtare” Vlorë, Industriale “Pavarësia” Vlorë, “Kristo Isak” Berat, Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Vlorë, “Ali Myftiu” Elbasan dhe “Sali Ceka” Elbasan.

GFA PROSEED

Projekti “Mbështetje për Qendrat e Formimit Profesional Publik”, pjesë e Programit të GIZ “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, promovimi i punësimit, arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri”, ProSEED, i cili zbatohet nga GFA Consulting Group. Institucionet që do të mbështeten nga ky projekt: 5 Qendra Publike të Formimit Profesional (QFP) në Rajonet: Shkodra, Durrësi, Korca, Gjirokastra & Elbasani. Aktivitetet e zhvilluara sipas objektivave të projektit: *a*) implementimi i paketës ‘Start Smart’, *b*) mplementimi i paketës së bashkëpunimit me biznesin për zhvillimin e praktikave profesionale pranë Qendrave të Formimit profesional; *c*) rishikimi i kurrikulave të zbatuara në QFP, etj.

MARRËVESHJE MOBILITETI PËR PUNË ME KOSOVËN

Projekti konsiston lidhjen e marrëveshjes që pritet të nënshkruhet midis dy ministrive respektive; Ministrisë së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë se Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja fokusohet mbi çështjet e punësimit dhe aftësimit profesional bazuar mbi orientimet e BE-së, zotimet që dalin nga procesi i Berlinit, bashkëveprimin ndërkufitar në kuadër të përafrimit të masave në lidhje me mobilitetin për punë dhe politikave të përbashkëta.



DIMAK- PROGRAMI GLOBAL MIGRIM PËR ZHVILLIM (PME)

Qendra Gjermane e Informacionit për Migracion, Arsim Profesional dhe Karrierë (DIMAK Albania) është pjesë e Programit Global “Migrim për Zhvillim”(PME), i cili zbatohet në Shqipëri nga Qendra Ndërkombëtare për Migrim dhe Zhvillim, një bashkëpunim i Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Zyrës së Agjencisë Federale për Punësim (BA). Objektivat kryesore të projektit janë: *a)* rritja e kapaciteteve në këshillimin e punësimit jashtë vendit për AKPA; *b)* këshillimi për arsim profesional dhe punësim në Shqipëri; *c)* informacion mbi risqet e migrimit të jashtëligjshëm dhe këshillim mbi migrimin e rregullt; *d)* këshillim në kthim dhe riintegrimi.



RCC (REGIONAL COOPERATION COUNCIL)

Regional Cooperation Council

The “Employment and Social Affairs Platform” (ESAP), është një projekt rajonal i financuar nga Komisioni Evropian dhe zbatohet nga Regional Cooperation Council (RCC) dhe ILO në ekonominë e Ballkanit Perëndimor. Projekti, i cili ka nisur zbatimin në vitin 2016 ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe kapacitetet institucionale të administratave kombëtare, organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve duke iu mundësuar zhvillimin dhe implementimin efektiv të tregut të punës dhe reformës së politikave sociale në procesin e tyre të integritimit në BE. Zhvillimet e fundit të AKPA në aspektet e përfshira nga Benchlearning fokusohen mbi; menaxhimin strategjik të performancës, planifikimi strategjik dhe operacional, që lidhen me ristrukturimin dhe riorganizimin e AKPA, menaxhimin e shërbimeve të punësimit, etj.



RISSI ALBANIA

Projekti ka në fokus kryesor marrëdhëniet bilaterale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Bizneseve (Punëdhënësve) me qëllim ndërtimin dhe rregullimin e metodologjisë së qasjes ndaj këtyre të fundit. Në këtë kuadër, Risi Albania, në kuadër të këtij projekti ka zhvilluar Udhëzuesin e AKPA për Ndërtimin dhe Zhvillimin e Marrëdhënieve të Bashkëpunimit me Punëdhënësin dhe Analizën e Tregut Rajonal të punës, Metodologjinë për Sistemin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Kënaqësisë Qytetare për AKPA, Sistemit të Menaxhimit të Ankesave, si dhe sipas komponentit të forcimit të ofrimit të shërbimeve të udhëzimeve të karrierës si dhe të ndërmjetësimit.



UNDP- SKILLS DEVELOPMENT FOR EMPLOYMENT PROGRAMME SD4E

Programi "Zhvillimi i aftësive për punësimin (SD4E)" mbështet Qeverinë e Shqipërisë në reformën kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Punësimit përmes një qasje gjithëpërfshirëse të ngritjes së kapaciteteve institucionale në një nivel makro/ politikash, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve të koordinuara dhe të drejtuara nga kërkesa. Duke iu përgjigjur përparësive kombëtare dhe objektiveve të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, kjo ndërhyrje e financuar nga Zvicra ka ambicien për të dhënë një kontribut të qëndrueshëm ku sistemi

shqiptar i AFP dhe Shërbimi i Punësimit furnizojnë punën treg me një fuqi punëtore të aftë që kombinohet me zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik të vendit. Programi do të mundësojë përmirësimin e menaxhimit, cilësisë së ofrimit të shërbimit në formimin profesional dhe nxitjen e punësimit në Shqipëri.



GIZ- Projekti "Fondi për AAP dhe Punësimin - MFC Kamza"

Qeveria Gjermane është angazhuar në mbështetjen e Qeverisë së Shqipërisë për përmirësimin e mëtejshëm të arsimit dhe aftësisë profesionale në Shqipëri, posaçërisht duke mbështetur krijimin e Qendrës Multifunktionale të Trajnimit (MFC) në Kamzë si një pilot për zgjerimin e mëtejshëm të MFC të synuar rrjeti në Shqipëri. Projekti "Fondi për AAP dhe Punësimin - MFC Kamza" është një projekt me rëndësi të veçantë që synon rehabilitimin, zgjerimin dhe ngritjen e kapaciteteve të shkollës ekzistuese të AAP në Kamzë për t'u bërë një MFC e plotë.

KAPITULLI IX- PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI

BUXHETOR

Bazuar në Ligjin nr.99/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”, janë miratuar fondet e për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në vlerën 1,699,000,000 lekë.

Tabela më poshtë detajon fondin e miratuar sipas programeve:

(mijë lekë)

Emërtimi	Buxheti Vjetor 2020	Buxheti i rishikuar Viti 2020	Diferenca	% në strukturë
Planifikim e Menaxhim (Admin.Qëndrore e SHKP)	80,000	73,520	-6,480	4%
Punësimi nga Zyrat e Punës	291,957	290,247	-1,710	15%
Nxitje Punësimi	390,000	252,908	-137,092	13%
Pagesë Papunësie	600,000	968,350	368,350	51%
Formimi Profesional Publik	299,043	281,753	-17,290	15%
Investime Buxhetore	300,000	40,800	-259,200	2%
	1,961,000	1,907,578	-53,422	100%

Nga sa më lart vihet re:

- 51% e buxhetit të miratuar për AKPA është planifikuar për Programin e Pagesës së Papunësisë,
- 13% për Programin e Nxitjes së Punësimit,
- 15% për Programin e Formimit Profesional Publik,
- 2% për investime buxhetore,
- 19% për Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit dhe Administratën Qëndrore të AKPA.

Në 6 mujorin e dytë të vitit 2019, vlera e buxhetit të rishikuar është 1,936,143,839 lekë, rreth 237.1 milion lekë më pak se buxheti i miratuar.

Duke u detajuar sipas zërave:

1. Shtesa në programin e pagesës së papunësisë në shumën rreth 368.3 milion lekë. Shtesa e fondit ka ardhur kryesisht nga si pasoje e rritjes së numrit të aplikuesve nga situata e krijuar nga pandemia dhe zbatimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 161, datë 21.03.2018 “Për pagesën të ardhurës nga papunësia” dhe VKM 254, datë 27.03.2020.
2. Pakësimi në programin e nxitjes së punësimit është në shumën rreth 137.1 milion lekë. Ky pakësim erdhi si rezultat i nisjes së programeve të reja të PNP në fund të vitit 2020.
3. Pakësim në zërin e Investimeve Buxhetore në shumën rreth 259.2 milion lekë